Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0613

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) P.M.N. SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Mbikëqyrja e Projekteve me numër të prokurimit 632-26-4696-2-1-1, me 29/09/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE P.M.N. SH.P.K. me nr. 2026/0613 , e datës 19/08/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mbikëqyrja e Projekteve me numër të prokurimit 632-26-4696-2-1-1.

2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA E GJAKOVËS, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Mbikëqyrja e Projekteve me numër të prokurimit 632-26-4696-2-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik P.M.N. SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.06.2026. KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Ftesën për ofertim, për aktivitetin e prokurimit MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE, me numër të prokurimit: 632-26-4696-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00 **€.**

Me 31.07.20206. KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), kunder njoftimit për dhënje të kontrates ku është rekomanduar për kontratë AL ENGINERING SH.P.K..

Me 05.08.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 10.08.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19.08.2026, OE "P.M.N." SH.P.K & NPN "UNIVERS-MI" ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0613, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder njoftimit për dhenje të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "P.M.N." SH.P.K & NPN "UNIVERS-MI".janë parashtruar si në vijim:

Dispozitat e shkelura të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, sipas "P.M.N." SH.P.K & NPN "UNIVERS-MI" Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE, me nr. të prokurimit: 632-26-4696-2-1-1, nga ana e Autoriteti Kontraktues/KOMUNA E GJAKOVËS janë si në vijim:

Dispozitat e LPP-së Neni 1 i LPP-së ,Neni 7 i LPP-së , Neni 10 i LPP-së , Neni 11 i LPP-së , Neni 59 i LPP-së , Neni 59.4 i LPP-së,Neni 69 i LPP-së ,Neni 72 i LPP-së , Dispozita e Rregullores ,Nenin 7.6.2 dhe 7.6.3 të Rregullores Nr. 002/2024,Neni 38 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Më 31.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar njoftimin mbi vendimin, sipas të cilit për tenderues të suksesshëm është rekomanduar OE "AL-Engineering" SH.P.K., me vlerë të ofertës 115,500.00 euro, ndërsa GOE "P.M.N." SH.P.K. & NPN "UNIVERS-MI" është njoftuar për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit.

Në të njëjtën datë, më 31.07.2026, "P.M.N." SH.P.K. ka paraqitur kërkesë me shkrim për qasje në dokumentet zyrtare të aktivitetit "Mbikëqyrja e Projekteve", me nr. të prokurimit 632-264696-2-1-1.

Me emailin e datës 03.08.2026, AK e ka njoftuar kërkuesin se mund të paraqitet gjatë orarit të punës për qasje në dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Megjithatë, gjatë qasjes së datës 03.08.2026, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar dokumentacionin e saktë dhe të plotë të tenderuesit të rekomanduar për kontratë. Nga verifikimi i dokumenteve të vëna në dispozicion është konstatuar se ato i përkisnin operatorit ekonomik N.N.P. "VETONI" dhe lidheshin me një projekt tjetër.

Se ky operator ekonomik nuk ka qenë pjesëmarrës në aktivitetin përkatës të prokurimit vërtetohet drejtpërdrejt nga Procesverbali i hapjes së tenderëve. Sipas tabelës së tenderuesve në faqen 1 të procesverbalit, në këtë aktivitet kanë marrë pjesë vetëm:

FST Engineering SH.P.K.; Grupi i Operatorëve Ekonomikë P.M.N. SH.P.K. dhe UNIVERS-MI;

AL-Engineering SH.P.K., MUH Engineering L.L.C. dhe HII NR.14 – PRISHTINË.

Në këtë listë zyrtare të operatorëve që kanë dorëzuar oferta nuk figuron N.N.P. "VETONI". Rrjedhimisht, dokumentet e këtij operatori nuk mund të konsiderohen pjesë e ofertës së tenderuesit të rekomanduar për kontratë, pasi ai nuk ka dorëzuar ofertë dhe nuk ka qenë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Për këtë parregullsi, më 04.08.2026, GOE e ka njoftuar me email Autoritetin Kontraktues se dokumentacioni i ofruar gjatë qasjes nuk ishte dokumentacioni i operatorit ekonomik të shpallur fitues. Në të njëjtin email është kërkuar që Autoriteti Kontraktues ta sqarojë urgjentisht gabimin dhe që dokumentacionin e saktë e të plotë të operatorit të shpallur fitues ta dërgojë menjëherë përmes emailit. Bashkë me njoftimin janë identifikuar dhe bashkëngjitur dokumentet e dorëzuara gabimisht, përfshirë certifikatën e biznesit, deklaratën nën betim, certifikatat ISO, listën e punëtorëve dhe paramasën e N.N.P. "VETONI".

Pavarësisht këtij njoftimi dhe kërkesës së qartë për mundësimin e qasjes, deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkese për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues:

nuk e ka dërguar dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues;

nuk ka njoftuar GOE-në se kur dhe në çfarë mënyre mund të realizohet qasja në këtë dokumentacion;

nuk ka dhënë asnjë sqarim lidhur me dokumentacionin e gabuar të vënë në dispozicion.

Parregullsitë e konstatuara gjatë qasjes dhe lidhur me eliminimin tonë

Gjatë realizimit të qasjes në dokumentet zyrtare të këtij aktiviteti të prokurimit, kemi konstatuar një varg parregullsish dhe mosveprimesh nga ana e Autoritetit Kontraktues, si në raport me dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, ashtu edhe në raport me arsyet dhe bazën mbi të cilën është bërë eliminimi ynë.

Në veçanti, Autoriteti Kontraktues nuk na ka mundësuar qasje të plotë, të saktë dhe efektive në dokumentacionin relevant, duke na ofruar dokumente që nuk i përkisnin operatorit ekonomik të shpallur fitues. Po ashtu, deri në paraqitjen e kësaj kërkese për rishqyrtim, nuk na është ofruar dokumentacioni i saktë dhe as nuk jemi njoftuar për mënyrën se si mund t'i qasemi atij.

Kjo mungesë e qasjes ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në mundësinë tonë për të verifikuar ligjshmërinë e eliminimit tonë, për të krahasuar trajtimin e ofertës sonë me atë të operatorit të rekomanduar për kontratë dhe për të konstatuar nëse kriteret janë zbatuar në mënyrë të barabartë

dhe konsistente ndaj të gjithë tenderuesve.

Për këtë arsye, parregullsitë e konstatuara gjatë qasjes në dokumente zyrtare, si dhe shkeljet që lidhen me eliminimin tonë, do të paraqiten dhe arsyetohen në vijim.

Shkelja e Nenit 10 të LPP-së – Pamundësimi i qasjes në dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues

Autoriteti Kontraktues ka cenuar të drejtën e GOE-së për qasje në dokumentacionin zyrtar të aktivitetit të prokurimit, duke vepruar në kundërshtim me parimin e transparencës dhe me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik.

Më 31.07.2026, GOE ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare të aktivitetit të prokurimit me titull "Mbikëqyrja e Projekteve", me numër prokurimi 632-26-4696-2-1-1.

Në përgjigje të kësaj kërkese, Autoriteti Kontraktues, më 03.08.2026 në ora 09:43, e ka njoftuar GOE-në se mund të paraqitej po atë ditë, gjatë orarit të punës, për realizimin e qasjes.

Megjithatë, gjatë qasjes së realizuar më 03.08.2026, në vend të dokumentacionit të operatorit ekonomik të shpallur fitues, Autoriteti Kontraktues ka vënë në dispozicion dokumentacion që i përkiste N.N.P. "VETONI" dhe që lidhej me një projekt tjetër. Ky operator nuk ka qenë pjesëmarrës në aktivitetin përkatës të prokurimit, siç vërtetohet edhe nga Procesverbali i hapjes së tenderëve.

Pas verifikimit të dokumenteve të marra, GOE, më 04.08.2026 në ora 10:31, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktues se dokumentacioni i dorëzuar ishte i pasaktë dhe se i përkiste një operatori jopjesëmarrës dhe një projekti tjetër. Në të njëjtin email është kërkuar sqarim urgjent dhe është kërkuar që dokumentacioni i saktë dhe i plotë i operatorit ekonomik të shpallur fitues të dërgohej menjëherë përmes emailit, me qëllim që GOE të mund ta analizonte dhe ta përgatiste kërkesën për rishqyrtim brenda afatit ligjor.

Autoriteti Kontraktues ka reaguar vetëm më 05.08.2026 në ora 09:44, pra në ditën e fundit të afatit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim, duke pranuar se kishte ndodhur gabim gjatë shkarkimit të dokumenteve dhe duke e ftuar GOE-në për riqasje fizike gjatë orarit të punës.

GOE i është përgjigjur më 05.08.2026 në ora 10:18, duke kërkuar që dokumentacioni i operatorit ekonomik të shpallur fitues t'i dërgohej urgjentisht përmes emailit, pasi nuk kishte më kohë të mjaftueshme për marrjen fizike, shqyrtimin dhe analizimin e detajuar të tij, ndërkohë që po atë ditë skadonte afati për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Pavarësisht këtyre kërkesave, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues:

nuk e ka dërguar dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues;

nuk ka ofruar qasje të menjëhershme në versionin e pastruar të dokumentacionit;

nuk ka mbajtur procesverbal për qasjen në dokumentacionin e saktë;

ka ofruar qasje me vonesë, në një mënyrë që nuk mundësonte analizimin efektiv të

dokumenteve brenda afatit ligjor;

ka vënë fillimisht në dispozicion dokumente të një operatori që nuk ka qenë pjesëmarrës në procedurë.

Me këto veprime dhe mosveprime, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin

10 të LPP-së, si dhe me Nenin 7.6.2 dhe 7.6.3 të Rregullores Nr. 001/2022, të ndryshuar me

Rregulloren Nr. 002/2024, të cilat obligojnë përgatitjen e versionit të pastruar të dokumentacionit dhe ofrimin e qasjes së menjëhershme sipas kërkesës së operatorit ekonomik.

Rrjedhimisht, GOE-së nuk i është mundësuar qasje reale, e plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, duke i pamundësuar verifikimin e ligjshmërisë së ofertës së tij dhe përgatitjen e plotë të kërkesës për rishqyrtim brenda afatit ligjor.

Pretendimi 2;Shkelja e Nenit 1 të Ligjit për Prokurimin Publik – Cenimi i ekonomicitetit dhe dëmi potencial ndaj buxhetit publik

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili synon të sigurojë përdorimin më efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, si dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në mënyrë që të mbrohet interesi publik dhe të garantohet konkurrencë e ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret, sipas Procesverbalit të hapjes së tenderëve, oferta e GOE P.M.N. SH.P.K. &

UNIVERS-MI ka qenë në vlerë prej 75,762.71 €, ndërsa oferta e GOE të shpallur fitues, ALEngineering SH.P.K., MUH Engineering L.L.C. & HII NR.14 – Prishtinë, ka qenë në vlerë prej 97,881.36 €.

Diferenca ndërmjet këtyre dy ofertave është: 97,881.36 € – 75,762.71 € = 22,118.65 €

Rrjedhimisht, oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë është 22,118.65 € më e lartë se oferta jonë, përkatësisht rreth 29.19% më e shtrenjtë.

Nëse eliminimi i ofertës sonë rezulton të jetë bërë pa bazë ligjore dhe oferta jonë ka qenë e përgjegjshme, atëherë vendimi i Autoritetit Kontraktues për rekomandimin e një oferte më të lartë e ekspozon buxhetin publik ndaj një shpenzimi shtesë dhe dëmi potencial në vlerë prej 22,118.65 €.

Për rrjedhojë, eliminimi i ofertës sonë dhe rekomandimi për kontratë i një operatori me çmim dukshëm më të lartë cenon qëllimin e Nenit 1 të LPP-së, veçanërisht parimin e përdorimit ekonomik dhe efikas të fondeve publike. Autoriteti Kontraktues, në vend që të siguronte përfitimin më të mirë ekonomik për paranë publike, ka rekomanduar një ofertë që e ngarkon buxhetin e shtetit me 22,118.65 € më shumë.

Prandaj, kërkohet që të rishqyrtohet ligjshmëria e eliminimit tonë dhe e rekomandimit për dhënie të kontratës, pasi, në rast të konstatimit se oferta jonë është eliminuar në mënyrë të kundërligjshme, vendimi i AK-së përbën cenim të Nenit 1 të LPP-së dhe i shkakton ose rrezikon t'i shkaktojë buxhetit publik një dëm financiar prej 22,118.65 €.

Pretendimi nr:3

– Arkitekti Driton Kabashi

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues në Dosjen e Tenderit

Në pikën c) të kërkesave për personelin profesional, AK ka kërkuar:

Një Arkitekt të diplomuar ose Master të Arkitekturës, të licencuar me Licencë A nga OARK, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Në sqarimet e DT-së është përcaktuar se përvoja profesionale duhet t'u përgjigjet projekteve të ngjashme, ndërsa kualifikimi shkollor duhet të jetë diplomë universitare me së paku 300 ECTS, sipas sistemit pesëvjeçar ose nivelit Master.

Dëshmitë e kërkuara në DT

AK ka kërkuar që kualifikimet shkollore dhe profesionale të stafit të dëshmohen me:

CV, diplomë; kontratë pune ose kontratë mbi vepër, në të cilën specifikohet titulli i projektit;

listën e stafit të angazhuar me emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozitën në kompani.

AK nuk ka kërkuar referenca profesionale si dëshmi të detyrueshme për përvojën e arkitektit

Për këtë arsye, vlerësimi i përvojës së z. Driton Kabashi duhet të bëhet në bazë të dokumenteve të përcaktuara shprehimisht në DT, e jo duke vendosur gjatë vlerësimit kërkesa shtesë lidhur me përmbajtjen ose periudhat e referencave.

Dokumentet e dorëzuara për z. Driton Kabashi

Për z. Driton Kabashi janë dorëzuar: diploma Master në Arkitekturë, me 303 ECTS, e përfunduar më 28.06.2018; Licenca A nr. A-0192; CV-ja profesionale;kontrata mbi vepër e datës 03.07.2026 për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve"; lista e stafit profesion :si dokumente shtesë, edhe disa referenca profesionale.

Kontrata mbi vepër e specifikon titullin e projektit, numrin e prokurimit dhe detyrat e z. Kabashi në projektim, mbikëqyrje ose menaxhim, prandaj është në përputhje me kërkesën e DT-së për angazhimin e stafit për projektin konkret.

Përvoja profesionale e paraqitur në CV

Në pjesën "Punësimi" të CV-së është deklaruar shprehimisht se z. Driton Kabashi ka punuar në NN "Kabashi":

"që nga viti 2015 e gjer më tani",

duke kryer punë të projektimit, përgatitjes së dokumentacionit për tenderim, organizimit të personelit dhe mbikëqyrjes së punës.

CV-ja paraqet gjithashtu se nga prilli 2023 z. Kabashi ushtron pozitën e Drejtorit Menaxhues dhe Arkitektit në "Kabashi-Projektim&Ndërtim" SH.P.K. Në CV janë paraqitur edhe angazhime profesionale në projektim dhe mbikëqyrje me Mercom Company, Euro Stil dhe Real Invest.

Z. Kabashi ka diplomuar më 28.06.2018, ndërsa afati i dorëzimit dhe hapjes së ofertave ka qenë më 13.07.2026. Nga data e diplomimit deri në datën e ofertimit kanë kaluar: 8 vite e 15 ditë.

Meqenëse CV-ja e dorëzuar paraqet angazhimin profesional "nga viti 2015 e gjer më tani", ajo dëshmon se angazhimi ka vazhduar edhe pas diplomimit dhe se periudha pas 28.06.2018 tejkalon minimumin prej 5 viteve të kërkuar në DT.

Prandaj, konstatimi i AK-së se CV-ja nuk përmban periudhën e përvojës nuk është i saktë. CVja përmban periudhën e angazhimit kryesor dhe vazhdimësinë e tij deri në kohën e ofertimit.

Përdorimi i referencave si bazë eliminimi

Në letrën e eliminimit, AK ka konstatuar se viti 2015 i paraqitur në CV nuk përputhet me datën 01.02.2017 në referencën e NN "Kabashi" dhe se "edhe nga referencat e prezantuara" nuk dëshmohet përvoja 5-vjeçare pas diplomimit.

Ky arsyetim nuk është në përputhje me kërkesat e DT-së, sepse referencat nuk janë kërkuar si dëshmi të detyrueshme.

Referencat janë dorëzuar si dokumente shtesë dhe mund të përdoren vetëm për të konkretizuar natyrën e punëve të kryera, por jo të shndërrohen në kriter të ri eliminues. AK nuk mund të kërkojë që referencat të përmbajnë data të sakta të fillimit dhe përfundimit, kur një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar në DT.

Edhe dallimi ndërmjet vitit 2015 në CV dhe datës 01.02.2017 në referencë nuk e rrëzon përvojën pas diplomimit. Të dyja datat janë para 28.06.2018, ndërsa dokumenti i kërkuar nga AK, përkatësisht CV-ja, paraqet vazhdimësinë e angazhimit "gjer më tani".

Projektet e ngjashme dhe jo projektet e njëjta

AK ka kërkuar përvojë që u përgjigjet projekteve të ngjashme, dhe jo projekteve të njëjta ose me titull identik me objektin e prokurimit.

Projekte të njëjta do të nënkuptonin projekte me titull, objekt dhe detyra identike. Ndërsa projekte të ngjashme përfshijnë projekte me natyrë, përgjegjësi dhe funksione profesionale të krahasueshme.

Përvoja e z. Kabashi : projektim arkitektonik: mbikëqyrje të objekteve; organizim dhe menaxhim të punimeve; menaxhim të punishtes; përgatitje të dokumentacionit teknik; trajtim të problemeve gjatë projektimit dhe mbikëqyrjes, është e ngjashme dhe profesionalisht e krahasueshme me objektin "Mbikëqyrja e Projekteve".

Referencat e dorëzuara, ndonëse nuk kanë qenë të detyrueshme, konfirmojnë natyrën e këtyre angazhimeve në projektim, mbikëqyrje dhe menaxhim.

Prandaj, AK nuk mund ta ngushtojë termin "projekte të ngjashme" në kërkesë për projekte të njëjta ose vetëm për projekte që mbajnë titullin "Mbikëqyrja e Projekteve".

Paqartësia eventuale duhej të sqarohej

Nëse AK ka konsideruar se shprehja “nga viti 2015 e gjer më tani” nuk ishte mjaftueshëm e saktë për shkak të mungesës së muajit ose datës së plotë, kjo përbënte një paqartësi të sqarueshme në CV, dhe jo mungesë të përvojës profesionale.

Sqarimi do të shërbente vetëm për konfirmimin e datës së fillimit dhe vazhdimësisë së një angazhimi që, sipas CV-së, ka ekzistuar para dorëzimit të tenderit. Ai nuk do të krijonte përvojë të re dhe as nuk do ta ndryshonte përmbajtjen materiale të ofertës.

Për këtë arsye, AK duhej të kërkonte sqarimin e të dhënave të paraqitura në CV, në pajtim me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, në vend që ta eliminonte ofertën duke u mbështetur në përmbajtjen e referencave që nuk ishin kërkuar në DT.

Shkeljet e Autoritetit Kontraktues

Me eliminimin e ofertës lidhur me z. Driton Kabashi, konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me:

Nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka ekzaminuar dhe vlerësuar dokumentacionin në tërësi dhe sipas dëshmive të përcaktuara në DT;

Nenin 69 të LPP-së, sepse aftësia teknike dhe profesionale nuk është vlerësuar sipas

kërkesëdhe mënyrës së dëshmimit të publikuar në DT;

Nenin 72 të LPP-së, sepse paqartësia eventuale lidhur me saktësinë e periudhës së deklaruar në CV mund të sqarohej pa ndryshuar ofertën;

Nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, lidhur me sqarimin e dokumenteve të aftësisë teknike dhe profesionale;

Nenin 7 të LPP-së, sepse AK nuk mund të vendosë gjatë vlerësimit kërkesa të reja për referenca dhe as ta shndërrojë termin “projekte të ngjashme” në kërkesë për projekte të njëjta.

Kërkojmë që Pretendimi nr. 1 të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me z. Driton Kabashi.

Pretendimi nr:4– Inxhinieri i Elektrikës Lulzim Halitaj

Kërkesa e AK-së në Dosjen e Tenderit

Në pikën d) të kërkesave për personelin profesional, AK ka kërkuar:

Një Inxhinier të Diplomuar ose Master në Inxhinieri Elektrike, me Licencë A nga OIRK dhe me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Në sqarimet e DT-së është përcaktuar se përvoja profesionale duhet t’u përgjigjet projekteve të ngjashme, ndërsa diploma duhet të jetë universitare me së paku 300 ECTS, sipas sistemit pesëvjeçar ose nivelit Master.

Dëshmitë e kërkuara në DT

AK ka kërkuar që kualifikimet shkollore dhe profesionale të stafit të dëshmohen me:

CV; diplomë; kontratë pune ose kontratë mbi vepër, ku specifikohet titulli i projektit;

listën e stafit të angazhuar me emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozitën në kompani.

AK nuk ka kërkuar referenca profesionale si dëshmi të detyrueshme për përvojën einxhinierit elektrik

Prandaj, përmbajtja ose ndonjë gabim material në referencat e dorëzuara si dokumente shtesë nuk mund të shndërrohet në kriter eliminues që nuk ka qenë i paraparë në DT.

Dokumentet e dorëzuara

Për z. Lulzim Halitaj janë dorëzuar:

diploma Master në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Elektroenergjetikë, me datë përfundimi04.05.2018;

Licenca A nr. E-0042, e vlefshme deri më 14.11.2029;

CV-ja profesionale;

kontrata mbi vepër për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve";

lista e stafit profesional;

lista e projekteve të menaxhuara;

si dokumente shtesë, referenca profesionale.

Kontrata mbi vepër e datës 09.07.2026 specifikon titullin "Mbikëqyrja e Projekteve", numrin e prokurimit dhe detyrat në projektim, mbikëqyrje ose menaxhim, duke e plotësuar kërkesën e DT-së për angazhimin në projektin konkret.

Përvoja profesionale e paraqitur në CV CV-ja paraqet qartë këto angazhime:

- EUROING: 2018–2026 dhe vazhdon, në pozitën Inxhinier Elektrik – Auditor i Energjisë;
- Syla Group: 2018–2022 dhe 2025–vazhdon;
- Valmet AB: 04.2014–12.2023;
- Links 4: 03.2016–03.2018;
- U Architects: 01.2014–03.2016.

Për angazhimin në EUROING, CV-ja përshkruan projektimin e instalimeve elektrike, përgatitjen e skemave dhe diagrameve, zbatimin e standardeve profesionale dhe integrimin e projekteve elektrike në projekte më të mëdha.

Për angazhimin në Links 4, CV-ja përfshin monitorimin e zbatimit të projekteve elektrike, kontrollin e përputhshmërisë me specifikimet, standardet e cilësisë dhe afatet, si dhe menaxhimin

dhe mbikëqyrjen e ekipeve dhe burimeve. Për U Architects përmendet gjithashtu monitorimi i projekteve në cilësinë e mbikëqyrësit.

Z. Halitaj ka diplomuar më 04.05.2018, ndërsa hapja e ofertave është bërë më 13.07.2026. Nga diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë kaluar:

8 vite, 2 muaj dhe 9 ditë.

CV-ja deklaron angazhim në EUROING nga viti 2018 deri në vitin 2026 dhe vazhdon. Rrjedhimisht, dokumenti që AK vetë e ka kërkuar paraqet një periudhë profesionale pas diplomimit që tejkalon minimumin prej 5 viteve.

Arsyeja e eliminimit

AK ka konstatuar se z. Halitaj nuk e dëshmon përvojën pesëvjeçare pas diplomimit në fushën e ngjashme dhe është mbështetur edhe në:

- pretendimin se referenca e EUROING-ut nuk përputhet me CV-në;
- faktin se në referencën e EUROING-ut është shënuar gabimisht emri “Emine Gllareva”;
- konstatimin se referenca e Syla Group dëshmon projektim dhe jo mbikëqyrje.

Ky arsyetim është i pabazuar, sepse referencat nuk kanë qenë dokumente të detyrueshme sipas DT-së. Përvoja është kërkuar të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontratë pune ose kontratë mbi vepër.

Lista e projekteve të menaxhuara

Në dokumentacion është dorëzuar edhe “Lista e Projekteve të Menaxhuara 2018–2025”, e cila përmban projekte të realizuara në kuadër të EUROING-ut, Syla Group, UA Architects, ConsultEng, G-Project dhe Studio Links 4.

Lista përfshin projektim, menaxhim, auditim energjetik, monitorim dhe realizim të projekteve elektrike e ndërtimore gjatë viteve 2018–2025.

Kjo listë, e vlerësuar së bashku me CV-në, e konkretizon natyrën profesionale të përvojës dhe tregon angazhime pas diplomimit për një periudhë më të gjatë se pesë vite.

Projekte të ngjashme, jo projekte të njëjta

DT-ja ka kërkuar përvojë në projekte të ngjashme, jo vetëm në projekte me titull identik “Mbikëqyrja e Projekteve”.

Projekt i njëjtë do të kërkonte objekt dhe detyra identike. Ndërsa projektet e ngjashme përfshijnë angazhime me natyrë dhe përgjegjësi profesionale të krahasueshme.

Përvoja e z. Halitaj përfshin

- projektimin e instalimeve elektrike;
- monitorimin e zbatimit të projekteve;

- kontrollin e përputhshmërisë me projektin, standardet dhe afatet;
- menaxhimin dhe udhëheqjen e projekteve;
- mbikëqyrjen e ekipeve dhe burimeve;
- auditimin energjetik;
- hartimin e raporteve dhe specifikimeve teknike

Këto detyra janë profesionalisht të ngjashme me mbikëqyrjen e projekteve. AK nuk mund ta ngushtojë termin "projekte të ngjashme" në pesë vite përvojë vetëm në projekte që mbajnë titullin formal "mbikëqyrje".

Fakti që referenca e Syla Group përdor termin "projektues" nuk e bën përvojën të parëndësishme, sepse DT nuk ka kërkuar projekte identike dhe as nuk ka kërkuar që çdo angazhim profesional të quhet formalisht "mbikëqyrje".

Paqartësia eventuale duhej të sqarohej

Nëse AK kishte paqartësi lidhur me

- natyrën e detyrave të paraqitura në CV;
- raportin ndërmjet CV-së dhe referencës së EUROING-ut;
- gabimin material në emër;
- periudhën e angazhimit profesional,

duhej të kërkonte sqarimin e dokumenteve ekzistuese dhe jo ta eliminonte ofertën.

Sqarimi nuk do të krijonte përvojë të re pas dorëzimit të tenderit, por vetëm do të konfirmonte të dhënat dhe angazhimet që ekzistonin para afatit të ofertimit.

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me z. Lulzim Halitaj, konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me:

· Nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka ekzaminuar dhe vlerësuar dokumentacionin në tërësi;

• Nenin 69 të LPP-së, sepse aftësia teknike dhe profesionale nuk është vlerësuar sipas kërkesave dhe dëshmive të përcaktuara në DT;

• Nenin 72 të LPP-së, sepse paqartësitë dhe gabimi material kanë mundur të sqarohen pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës;

• Nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, sepse AK ka mundur të kërkojë sqarimin e dokumenteve të aftësisë teknike dhe profesionale;

• Nenin 7 të LPP-së, sepse AK ka zbatuar një interpretim më kufizues se formulimi i publikuar, duke i trajtuar "projektet e ngjashme" sikur të kërkoheshin projekte të njëjta

Kërkojmë që Pretendimi nr. 2 të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me z. Lulzim Halitaj.

Pretendimi nr;5

Inxhinieri i Gjeodezisë, z. Luan Abazi

Kërkesa e AK-së në Dosjen e Tenderit

Në pikën ë) të kërkesave për personelin profesional, AK ka kërkuar:

Një Bachelor të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, drejtimi Gjeodezi, të licencuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Në këtë pikë të DT-së, ndryshe nga kërkesat për disa pozita të tjera të stafit, nuk është përcaktuar shprehimisht minimumi prej 5 viteve përvojë pas diplomimit.

Në pjesën e sqarimeve është përcaktuar në mënyrë të përgjithshme se përvoja profesionale nënkupton përvojë që u përgjigjet projekteve të ngjashme, 5 vite pas diplomimit. Edhe nëse ky sqarim konsiderohet i zbatueshëm për pozitën e gjeodetit, z. Luan Abazi e tejkalon dukshëm këtë periudhë.

Dëshmitë e kërkuara në DT

AK ka kërkuar që kualifikimet shkollore dhe profesionale të stafit të dëshmohen me:

• CV;

• diplomë;

• kontratë pune ose kontratë mbi vepër, ku specifikohet titulli i projektit;

• listën e stafit profesional me emër, mbiemër, profesion dhe pozitë në kompani.

AK nuk ka kërkuar referenca profesionale si dëshmi të detyrueshme.

Prandaj, vlerësimi duhej të bëhej mbi bazën e CV-së, diplomës, licencës dhe kontratës së angazhimit, ndërsa referencat e dorëzuara mund të shërbenin vetëm si dokumente plotësuese.

Dokumentet e dorëzuara për z. Luan Abazi

Për z. Luan Abazi janë dorëzuar:

• diploma Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi, e lëshuar më 18.02.2014;

• licenca nr. 129 për gjeodet të licencuar, e lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, e vlefshme deri më 20.10.2028;

• CV-ja profesionale;

• kontrata mbi vepër për projektin “Mbikëqyrja e Projekteve”;

• lista e stafit profesional;

• dokumente dhe referenca plotësuese për projekte gjeodezike dhe infrastrukturore.

Kontrata mbi vepër e datës 02.07.2026 specifikon projektin "Mbikëqyrja e Projekteve", numrin e prokurimit dhe angazhimin e z. Abazi për projektin konkret, duke përmbushur kërkesën e DT së për kontratën mbi vepër.

Përvoja profesionale e paraqitur në CV

Në CV është deklaruar se z. Luan Abazi është i angazhuar:

"Janar 2013 – vazhdon"

si Ekspert i Gjeodezisë, Drejtor i N.SH. "Geo&Metri" dhe gjeodet i licencuar, me detyra në matje inxhinierike dhe kadastrale.

Në CV paraqiten gjithashtu:

• matje gjeodezike;

• piketim;

• mbikëqyrje profesionale;

• matje me GPS dhe TCR;

• hartim dhe revidim projektesh;

• projekte rrugore dhe infrastrukturore;

• projekti "Mbikëqyrja e projekteve investive Lot 1/Pjesa 1".

Z. Abazi ka diplomuar më 18.02.2014, ndërsa hapja e ofertave është bërë më 13.07.2026. Nga diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë kaluar: 12 vite, 4 muaj dhe 25 ditë.

Meqenëse CV-ja paraqet angazhimin profesional nga janari 2013 dhe vazhdon, rezulton se përvoja e tij pas diplomimit tejkalon dukshëm minimumin prej 5 viteve, edhe nëse ky kusht konsiderohet i zbatueshëm për pozitën ë).

Arsyeja e eliminimit

AK ka konstatuar se z. Luan Abazi nuk e dëshmon me CV dhe referenca minimumin prej 5 viteve përvojë pas diplomimit në fushën e ngjashme, përkatësisht në mbikëqyrje të projekteve.

Ky konstatim është i pabazuar për dy arsye kryesore:

Së pari, në pikën specifike ë) të DT-së nuk është kërkuar shprehimisht përvojë minimale pesëvjeçare. Kërkesa specifike është kufizuar në kualifikimin Bachelor në Gjeodezi dhe licencimin nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Së dyti, edhe nëse zbatohet sqarimi i përgjithshëm për pesë vite pas diplomimit, CV-ja paraqet angazhim nga janari 2013 dhe vazhdon, ndërsa nga diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë

kaluar mbi 12 vite.

Referencat nuk kanë qenë dëshmi e detyrueshme

AK është mbështetur në konstatimin se edhe referencat nuk dëshmojnë përvojën pesëvjeçare. Megjithatë, DT-ja nuk ka kërkuar referenca si dëshmi të detyrueshme. Prandaj, AK nuk mund t'i shndërrojë referencat e dorëzuara si dokumente plotësuese në kriter të ri eliminues.

Në çdo rast, dokumentet plotësuese paraqesin projekte konkrete në:

• incizime gjeodezike;

• rrugë dhe infrastrukturë;

• kanalizim dhe ujësjellës;

• matje dhe piketim;

• menaxhim dhe mbikëqyrje profesionale;

• projekte investive dhe publike.

Këto dokumente e përforcojnë, dhe nuk e mohojnë, përvojën e paraqitur në CV.

Projekte të ngjashme, jo projekte të njëjta

DT-ja ka përdorur termin "projekte të ngjashme", jo "projekte të njëjta".

Një projekt i njëjtë do të kërkonte titull, objekt dhe detyra identike me aktivitetin e prokurimit. Projektet e ngjashme përfshijnë veprimtari me natyrë dhe përgjegjësi profesionale të krahasueshme.

Përvoja e z. Luan Abazi në:

• matje gjeodezike;

• piketim;

• incizime të terrenit;

• kontroll dhe mbikëqyrje profesionale;

• projekte rrugore;

• kanalizim dhe ujësjellës;

• menaxhim të projekteve gjeodezike,

është drejtpërdrejt e krahasueshme me detyrat e gjeodetit në kuadër të mbikëqyrjes së projekteve.

Për më tepër, në CV është paraqitur edhe projekti me titull "Mbikëqyrja e projekteve investive Lot 1/Pjesa 1", i cili lidhet drejtpërdrejt me objektin e aktivitetit të prokurimit.

AK nuk mund ta kufizojë përvojën e ngjashme vetëm në projekte që mbajnë titull identik "Mbikëqyrja e Projekteve".

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me z. Luan Abazi, konsiderojmë se AK ka vepruar në

kundërshtim me:

• Nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka vlerësuar dokumentacionin në tërësi;

• Nenin 69 të LPP-së, sepse nuk e ka vlerësuar aftësinë teknike dhe profesionale sipas

kërkesës specifike dhe dëshmive të përcaktuara në DT;

• Nenin 72 të LPP-së, sepse çdo paqartësi eventuale rreth natyrës ose vazhdimësisë së

angazhimit mund të sqarohej pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës;

• Nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, lidhur me sqarimin e dokumenteve të aftësisë teknike dhe profesionale;

• Nenin 7 të LPP-së, sepse AK ka aplikuar një interpretim më kufizues se formulimi i

publikuar dhe ka trajtuar projektet e ngjashme sikur të kërkoheshin projekte të njëjta.

Kërkojmë që Pretendimi nr. 3 të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me z. Luan Abazi.

Pretendimi nr. 6

– Inxhinieri i Gjeodezisë, z. Agron Shabani

Kërkesa e AK-së në Dosjen e Tenderit

Në pikën ë1) AK ka kërkuar:

Një Bachelor të Gjeodezisë.

Në këtë kërkesë specifike nuk është përcaktuar shprehimisht minimumi prej 5 viteve

përvojë pas diplomimit. Në pjesën e përgjithshme të sqarimeve është përmendur përvoja në

projekte të ngjashme, 5 vite pas diplomimit. Edhe nëse ky sqarim konsiderohet i zbatueshëm për

pozitën ë1), z. Agron Shabani e plotëson dhe e tejkalon këtë kusht.

Dëshmitë e kërkuara nga AK

AK ka kërkuar që kualifikimet shkollore dhe profesionale të stafit të dëshmohen me:

• CV;

• diplomë;

• kontratë pune ose kontratë mbi vepër me titullin e projektit;

• listën e stafit me emër, mbiemër, profesion dhe pozitë.

AK nuk ka kërkuar referenca si dëshmi të detyrueshme. Për këtë arsye, referencat e dorëzuara si dokumente plotësuese nuk mund të shndërrohen gjatë vlerësimit në kriter të ri eliminues.

Dokumentet e dorëzuara

Për z. Agron Shabani janë dorëzuar:

• diploma Bachelor në Gjeodezi, e përfunduar më 27.07.2011;

• CV-ja profesionale;

• kontrata mbi vepër e datës 07.07.2026 për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve";

• lista e stafit profesional;

• licenca nr. 380 për gjeodet të licencuar, e vlefshme deri më 03.06.2031;

• si dokumente plotësuese, referenca profesionale.

Kontrata mbi vepër e specifikon titullin e projektit, numrin e prokurimit dhe angazhimin në projektim, mbikëqyrje ose menaxhim, duke e plotësuar kërkesën e DT-së për angazhimin në projektin konkret.

Përvoja profesionale e paraqitur në CV

Në CV është deklaruar se z. Agron Shabani është i angazhuar:

Nga viti 2013 e tutje në N.SH. "GEO-MAP", në pozitën Drejtues Teknik.

CV-ja paraqet angazhime konkrete si:

• udhëheqës i matjeve gjeodezike gjatë viteve 2013–2014;

• menaxher projekti në vitin 2014;

· menaxher dhe udhëheqës i matjeve gjeodezike në vitin 2015;

• menaxher projekti për incizime gjeodezike në vitin 2017;

• menaxher projekti në projekte rrugore, infrastrukturore dhe incizime gjeodezike në vitin

2019.

Z. Shabani ka diplomuar më 27.07.2011, ndërsa hapja e ofertave është bërë më 13.07.2026. Nga

diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë kaluar:

14 vite, 11 muaj dhe 16 ditë.

CV-ja paraqet angazhim profesional nga viti 2013 dhe në vazhdim. Prandaj, edhe vetëm periudha nga viti 2013 deri në hapjen e ofertave tejkalon dukshëm minimumin prej 5 viteve pas diplomimit.

Arsyeja e eliminimit

AK ka konstatuar se z. Agron Shabani nuk e dëshmon me CV dhe referenca minimumin prej 5 viteve përvojë pas diplomimit në fushën e ngjashme, përkatësisht në mbikëqyrje të projekteve.

Ky konstatim është i pabazuar, sepse:

1. Kërkesa specifike ë1) ka kërkuar vetëm Bachelor në Gjeodezi dhe nuk ka përcaktuar shprehimisht përvojën pesëvjeçare;

2. edhe nëse zbatohet sqarimi i përgjithshëm, CV-ja paraqet angazhim nga viti 2013 e tutje;

3. AK nuk ka kërkuar referenca si dëshmi të detyrueshme;

4. dokumentet e dorëzuara paraqesin angazhime të shumta në udhëheqje, menaxhim dhe punë gjeodezike e infrastrukturore.

Referencat si dokumente plotësuese

Referencat nuk ishin kërkuar në DT, por ato e përforcojnë përvojën e paraqitur në CV.

Referenca e N.SH. “GEO-MAP” konfirmon se z. Shabani është i angazhuar nga 01.09.2013 e gjer më sot si:

“Udhëheqës–Mbikëqyrës i punëve gjeodezike dhe kadastrale.”

Në të paraqiten projekte konkrete në matje gjeodezike, kadastër, rrugë, kanalizim dhe incizime gjeodezike.

Referenca e Pro&Co Group konfirmon angazhimin e tij në përcjelljen e punëve gjeodezike, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e punishtes në projekte të ujësjellësit, kanalizimit, trotuareve, rrugëve dhe urave. Referenca e N.P.N. “Lori” konfirmon punësimin nga shtatori 2011 deri në korrik 2013 në punë kadastrale dhe gjeodezike.

Këto referenca nuk janë baza e vetme e përmbushjes së kriterit, por dokumente shtesë që e konkretizojnë natyrën e përvojës së paraqitur në CV.

Projekte të ngjashme, jo projekte të njëjta

DT-ja ka kërkuar përvojë në projekte të ngjashme, jo vetëm në projekte me titull identik “Mbikëqyrja e Projekteve”.

Përvoja e z. Agron Shabani përfshin:

• udhëheqje dhe mbikëqyrje të punëve gjeodezike;

• përcjellje të realizimit të punëve në punishte;

• matje dhe incizime gjeodezike;

• menaxhim projektesh;

• projekte rrugore, kanalizimi, ujësjellësi, trotuare, ura dhe infrastrukturë publike.

Këto detyra janë të krahasueshme me funksionin e gjeodetit në mbikëqyrjen e projekteve. Për më tepër, referencat përdorin shprehimisht termat “udhëheqës–mbikëqyrës”, “mbikëqyrje të punëve” dhe “mbikëqyrje të punishtes”.

AK nuk mund ta kufizojë termin “projekte të ngjashme” vetëm në projekte me titull identik ose vetëm në kontrata të emërtuara formalisht “mbikëqyrje”.

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me z. Agron Shabani, konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me:

• Nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka vlerësuar dokumentacionin në tërësi;

• Nenin 69 të LPP-së, sepse aftësia teknike dhe profesionale nuk është vlerësuar sipas kërkesës dhe dëshmive të përcaktuara në DT;

• Nenin 72 të LPP-së, sepse çdo paqartësi eventuale për periudhën ose natyrën e angazhimeve mund të sqarohej pa ndryshuar ofertën;

• Nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, lidhur me sqarimin e dokumenteve të aftësisë teknike dhe profesionale;

• Nenin 7 të LPP-së, sepse AK ka aplikuar një kërkesë më kufizuese se ajo e publikuar, duke i trajtuar projektet e ngjashme sikur të kërkoheshin projekte të njëjta.

Kërkojmë që Pretendimi nr. 4 të aprovohet si i bazuar, të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me z. Agron Shabani dhe oferta të kthehet në rivlerësim.

Pretendimi nr7

– Pajisja nr. 1, Instrumenti GPS për matje gjeodezike

Kërkesa e AK-së

Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në

Aneksin 7 të DT.

Në Aneksin 7 është kërkuar:

Instrumenti GPS për matje gjeodezike (instrumenti duhet të jetë i Kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike)

Dëshmia e kërkuar nga AK

Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.Marreveshja duhet te jete e nenshkruar dhe e vertetuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit

Arsyetimi i pretendimit

Ky konstatim është i pabazuar dhe nuk mbështetet në kërkesat e Dosjes së Tenderit.

OE ka dorëzuar marrëveshjen për shfrytëzimin e Instrumentit GPS për matje gjeodezike, të lidhur ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe GeoMetri SH.P.K., të nënshkruar dhe të vulosur nga të dyja palët, duke përmbushur kërkesën e AK-së për dëshminë e posedimit të pajisjes nëpërmjet marrëveshjes së shfrytëzimit. Në marrëveshje është identifikuar shprehimisht pajisja

"Instrumenti GPS për matje gjeodezike (instrumenti duhet të jetë i Kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike)".

Megjithatë, në pjesën "Dëshmia e kërkuar", AK nuk ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë certifikatë kalibrimi, raport teknik, raport servisi apo ndonjë dokument tjetër që dëshmon gjendjen teknike ose kalibrimin e pajisjes. Dëshmia e kërkuar kufizohet në dokumentet që provojnë pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes.

Për rrjedhojë, AK nuk mund ta eliminojë ofertën për mungesën e një dokumenti që nuk është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit. Një interpretim i tillë përbën vendosje të një kriteri shtesë gjatë fazës së vlerësimit, në kundërshtim me kërkesat e publikuara në DT.

Edhe nëse AK ka pasur paqartësi lidhur me kalibrimin ose gjendjen teknike të pajisjes, kjo nuk përbën mungesë të kriterit, por paqartësi të dokumentacionit. Në një situatë të tillë, AK ka mundur të kërkojë informata ose dokumente sqaruese për verifikimin e një gjendjeje që ka ekzistuar para afatit të dorëzimit të tenderëve, në vend që ta eliminojë ofertën.

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me pajisjen nr. 1, AK ka vepruar në kundërshtim me:

• nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka vlerësuar dokumentacionin sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit;

• nenin 69 të LPP-së, sepse ka kërkuar një dëshmi që nuk është përcaktuar në DT;

• nenin 72 të LPP-së, sepse nuk ka kërkuar sqarime për një paqartësi eventuale lidhur me dokumentacionin;

• nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, sepse nuk ka shfrytëzuar mundësinë për të kërkuar sqarime për dokumentet ekzistuese pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës;

• nenin 7 të LPP-së, sepse gjatë vlerësimit ka aplikuar një kriter që nuk ishte publikuar si dëshmi e detyrueshme në Dosjen e Tenderit.

Kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me pajisjen nr. 1

Pretendimi nr. 8

– Pajisja nr. 2 Instrument (termometer) për matjen e temperaturës së asfaltit gjatë procesit të shtruarjes, i cili punon sipas standardit EN 13108

Kërkesa e AK-së në DT

Në Aneksin 7 është kërkuar:

Instrument (termometer) për matjen e temperaturës së asfaltit gjatë procesit të shtruarjes, i cili punon sipas standardit EN 13108

Dëshmia e kërkuar nga AK në DT

Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.Marreveshja duhet te jete e nenshkruar dhe e vertetuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit

Arsyeja e eliminimit nga AK

Mungon dëshmia qe pajisja me nr. 2 ne listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 13108

Ky konstatim i AK-së është i pabazuar dhe nuk mbështetet në dëshminë e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Në listën e pajisjeve, OE ka deklaruar se ofron pajisjen nr. 2, përkatësisht:

Instrument (termometer) për matjen e temperaturës së asfaltit gjatë procesit të shtruarjes, i cili punon sipas standardit EN 13108

Po ashtu, është dorëzuar marrëveshja për qeranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K., ku kjo pajisje është identifikuar shprehimisht me të njëjtin përshkrim dhe me kërkesën që punon sipas standardit EN 13108. Marrëveshja është e nënshkruar dhe e vulosur nga palët dhe është lidhur për projektin konkret “Mbikëqyrja e Projekteve”, me nr. të prokurimit 632-26-4696-2-1-1.

Në pjesën “Dëshmia e kërkuar”, AK nuk ka përcaktuar se operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatë të konformitetit, certifikatë kalibrimi, raport testimi, deklaratë të prodhuesit ose ndonjë dokument tjetër të posaçëm që dëshmon funksionimin sipas standardit EN 13108.

Dëshmia e kërkuar nga AK ka qenë dokumentacioni që vërteton pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes. OE ka dorëzuar pikërisht marrëveshjen e kërkuar për shfrytëzimin e saj.

Prandaj, AK nuk mund ta eliminojë ofertën për mungesën e një dokumenti që nuk është përcaktuar shprehimisht si dëshmi e detyrueshme në Dosjen e Tenderit. Një kërkesë e tillë do të përbënte vendosje të një kriteri shtesë gjatë fazës së vlerësimit.

Edhe nëse AK ka pasur paqartësi nëse pajisja e ofruar punon sipas standardit EN 13108, kjo ka mundur të sqarohet përmes kërkesës për informata ose dokumentacion sqarues lidhur me pajisjen ekzistuese, pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës.

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me pajisjen nr. 2, AK ka vepruar në kundërshtim me:

• nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka vlerësuar në tërësi listën e pajisjeve dhe marrëveshjen e dorëzuar;

• nenin 69 të LPP-së, sepse ka kërkuar një dëshmi që nuk është përcaktuar në DT;

• nenin 72 të LPP-së, sepse nuk ka kërkuar sqarim për një paqartësi eventuale lidhur me përputhshmërinë e pajisjes me standardin;

• nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, sepse ka mundur të kërkojë dokumentacion sqarues pa ndryshuar ofertën;

• nenin 7 të LPP-së, sepse gjatë vlerësimit ka aplikuar një kërkesë më kufizuese se ajo e publikuar në DT.

Kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me pajisjen nr. 1

Pretendimi nr;8– Pajisja nr. 2 Instrument (termometer) për matjen e temperaturës së asfaltit gjatë procesit të shtruarjes, i cili punon sipas standardit EN 13108

Kërkesa e AK-së në DT

Në Aneksin 7 është kërkuar:

Instrument (termometer) për matjen e temperaturës së asfaltit gjatë procesit të shtruarjes, i cili punon sipas standardit EN 13108

Dëshmia e kërkuar nga AK në DT

Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe ibrezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.Marreveshja duhet te jete e nenshkruar dhe e vertetuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit

Arsyeja e eliminimit nga AK

Mungon dëshmia qe pajisja me nr. 2 ne listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 13108

Ky konstatim i AK-së është i pabazuar dhe nuk mbështetet në dëshminë e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Në listën e pajisjeve, OE ka deklaruar se ofron pajisjen nr. 2, përkatësisht:

Instrument (termometer) për matjen e temperaturës së asfaltit gjatë procesit të shtruarjes, i cili punon sipas standardit EN 13108

Po ashtu, është dorëzuar marrëveshja për qeranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K., ku kjo pajisje është identifikuar shprehimisht me të njëjtin përshkrim dhe me kërkesën që punon sipas standardit EN 13108. Marrëveshja është e nënshkruar dhe e vulosur nga palët dhe është lidhur për projektin konkret "Mbikëqyrja e Projekteve", me nr. të prokurimit 632-26-4696-2-1-1.

Në pjesën "Dëshmia e kërkuar", AK nuk ka përcaktuar se operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatë të konformitetit, certifikatë kalibrimi, raport testimi, deklaratë të prodhuesit ose ndonjë dokument tjetër të posaçëm që dëshmon funksionimin sipas standardit EN 13108.

Dëshmia e kërkuar nga AK ka qenë dokumentacioni që vërteton pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes. OE ka dorëzuar pikërisht marrëveshjen e kërkuar për shfrytëzimin e saj.

Prandaj, AK nuk mund ta eliminojë ofertën për mungesën e një dokumenti që nuk është përcaktuar shprehimisht si dëshmi e detyrueshme në Dosjen e Tenderit. Një kërkesë e tillë do të përbënte vendosje të një kriteri shtesë gjatë fazës së vlerësimit.

Edhe nëse AK ka pasur paqartësi nëse pajisja e ofruar punon sipas standardit EN 13108, kjo ka mundur të sqarohet përmes kërkesës për informata ose dokumentacion sqarues lidhur me pajisjen ekzistuese, pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës.

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me pajisjen nr. 2, AK ka vepruar në kundërshtim me:

- nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka vlerësuar në tërësi listën e pajisjeve dhe marrëveshjen e dorëzuar;
- nenin 69 të LPP-së, sepse ka kërkuar një dëshmi që nuk është përcaktuar në DT;
- nenin 72 të LPP-së, sepse nuk ka kërkuar sqarim për një paqartësi eventuale lidhur me përputhshmërinë e pajisjes me standardin;
- nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, sepse ka mundur të kërkojë dokumentacion sqarues pa ndryshuar ofertën;
- nenin 7 të LPP-së, sepse gjatë vlerësimit ka aplikuar një kërkesë më kufizuese se ajo e publikuar në DT.

Kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me pajisjen nr. 2

Pretendimi nr:9- Pajisja nr. 4 Kon metalik me pajisjet përcjellëse për testimin e betonit të njomë përmes metodës së konit të Abramsit i cili punon sipas standardit EN 12350-2

Kërkesa e AK-së në DT

4. Kon metalik me pajisjet përcjellëse për testimin e betonit të njomë përmes metodës së konit të Abramsit i cili punon sipas standardit EN 12350-2 1 1 Me marreveshje (shiko paisjet)

Dëshmia e kërkuar nga AK në DT

Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe

Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka

marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për

shfrytëzim.Marreveshja duhet te jete e nenshkruar dhe e vertetuar ne mes te qiramarrësi dhe

qiradhënësit

Arsyeja e eliminimit nga AK

Mungon dëshmia qe pajisja me nr. 4 ne listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 12350-2

Ky konstatim i AK-së është i pabazuar dhe nuk mbështetet në dëshminë e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Në Aneksin 7 është kërkuar pajisja “Kon metalik me pajisjet përcjellëse për testimin e betonit të njomë përmes metodës së konit të Abramsit i cili punon sipas standardit EN 12350-2”, ndërsa është përcaktuar se pajisja ofrohet “Me marreveshje (shiko paisjet)”.

OE ka dorëzuar marrëveshjen për qeranë e pajisjeve, të lidhur ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K., ku pajisja nr. 4 është identifikuar me të njëjtin përshkrim dhe me standardin EN 12350-2. Marrëveshja është e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët dhe është lidhur për aktivitetin e prokurimit “Mbikëqyrja e Projekteve”, me nr. të prokurimit 632-26-4696-2-1-1.

Në pjesën “Dëshmia e kërkuar”, AK nuk ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë certifikatë konformiteti, raport testimi, deklaratë të prodhuesit apo dokument tjetër të posaçëm që vërteton se pajisja punon sipas standardit EN 12350-2. Dëshmia e kërkuar ka qenë dokumentacioni që vërteton pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes, ndërsa OE ka dorëzuar marrëveshjen e kërkuar.

Për rrjedhojë, AK nuk mund ta eliminojë ofertën për mungesën e një dokumenti që nuk është përcaktuar shprehimisht si dëshmi e obligueshme në Dosjen e Tenderit. Një interpretim i tillë përbën vendosje të një kërkese shtesë gjatë fazës së vlerësimit.

Edhe nëse AK ka pasur paqartësi nëse pajisja e ofruar punon sipas standardit EN 12350-2, kjo paqartësi ka mundur të sqarohej përmes kërkesës për informata ose dokumentacion sqarues, pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës.

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me pajisjen nr. 4, AK ka vepruar në kundërshtim me:

- nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka vlerësuar në tërësi listën e pajisjeve dhe marrëveshjen e dorëzuar;

- nenin 69 të LPP-së, sepse ka kërkuar një dëshmi që nuk është përcaktuar në DT;

- nenin 72 të LPP-së, sepse nuk ka kërkuar sqarim për paqartësinë eventuale lidhur me përputhshmërinë e pajisjes me standardin;

- nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, sepse ka mundur të kërkojë dokumentacion sqarues pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës;

- nenin 7 të LPP-së, sepse gjatë vlerësimit ka aplikuar një kërkesë më kufizuese se ajo e publikuar në DT.

Kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me pajisjen nr. 4

Pretendimi nr10– Pajisja nr. 5 pllakë për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave te konstruksionit te rrugës (Moduli Dinamik dhe Moduli Statik) sipas standardit EN 13792

Kërkesa e AK-së në DT

5. pllakë për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave te konstruksionit te rrugës (Moduli Dinamik dhe Moduli Statik) sipas standardit EN 13792

Dëshmia e kërkuar nga AK në DT

Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.Marreveshja duhet te jete e nenshkruar dhe e vertetuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit

Arsyeja e eliminimit nga AK

Mungon dëshmia qe pajisja me nr. 5 ne listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 13792

Ky konstatim i AK-së është i pabazuar dhe nuk mbështetet në dëshminë e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Në Aneksin 7 është kërkuar pajisja “pllakë për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave te konstruksionit te rrugës (Moduli Dinamik dhe Moduli Statik) sipas standardit EN 13792”, ndërsa është përcaktuar se pajisja ofrohet “Me marreveshje (shiko paisjet)”.

OE ka dorëzuar marrëveshjen për qeranë e pajisjeve, të lidhur ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K., ku pajisja nr. 5 është identifikuar me të njëjtin përshkrim dhe me standardin EN 13792. Marrëveshja është e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët dhe është lidhur për aktivitetin e prokurimit “Mbikëqyrja e Projekteve”, me nr. të prokurimit 632-26-4696-2-1-1.

Në pjesën “Dëshmia e kërkuar”, AK nuk ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë certifikatë konformiteti, raport testimi, deklaratë të prodhuesit apo dokument tjetër të posaçëm që vërteton se pajisja punon sipas standardit EN 13792. Dëshmia e kërkuar ka qenë dokumentacioni që vërteton pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes, ndërsa OE ka dorëzuar marrëveshjen e kërkuar.

Për rrjedhojë, AK nuk mund ta eliminojë ofertën për mungesën e një dokumenti që nuk është përcaktuar shprehimisht si dëshmi e obligueshme në Dosjen e Tenderit. Një interpretim i tillë përbën vendosje të një kërkese shtesë gjatë fazës së vlerësimit.

Edhe nëse AK ka pasur paqartësi nëse pajisja e ofruar punon sipas standardit EN 13792, kjo paqartësi ka mundur të sqarohej përmes kërkesës për informata ose dokumentacion sqarues, pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës.

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me pajisjen nr. 5, AK ka vepruar në kundërshtim me:

- nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka vlerësuar në tërësi listën e pajisjeve dhe marrëveshjen e dorëzuar;

- nenin 69 të LPP-së, sepse ka kërkuar një dëshmi që nuk është përcaktuar në DT;

- nenin 72 të LPP-së, sepse nuk ka kërkuar sqarim për paqartësinë eventuale lidhur me përputhshmërinë e pajisjes me standardin;

- nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, sepse ka mundur të kërkojë dokumentacion sqarues pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës;

- nenin 7 të LPP-së, sepse gjatë vlerësimit ka aplikuar një kërkesë më kufizuese se ajo e publikuar në DT.

Kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me pajisjen nr. 5

Pretendimi nr11– Pajisja nr. 7 Instrument për matjen e trashësisë së shtresës së ngjyrës në sinjalizimin horizontal, i cili punon sipas standardit ISO 2808, EN ISO 2808, ASTM D 4414

Kërkesa e AK-së në DT

7. Instrument për matjen e trashësisë së shtresës së ngjyrës në sinjalizimin horizontal, i cili punon sipas standardit ISO 2808, EN ISO 2808, ASTM D 4414

Dëshmia e kërkuar nga AK në DT

Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim. Marreveshja duhet te jete e nenshkruar dhe e vertetuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.

Arsyetimi i pretendimit

Ky konstatim i AK-së është i pabazuar dhe nuk mbështetet në dëshminë e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Në Aneksin 7 është kërkuar pajisja "Instrument për matje të trashësisë së ngjyrës sipas standardit ISO 2808, EN ISO 2808, ASTM D 4414", ndërsa është përcaktuar se pajisja ofrohet "Me marreveshje (shiko paisjet)".

OE ka dorëzuar marrëveshjen për qeranë e pajisjeve, të lidhur ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe

I.T.K. SH.P.K., ku pajisja nr. 7 është identifikuar me të njëjtin përshkrim, përkatësisht

"Instrument për matje të trashësisë së ngjyrës sipas standardit ISO 2808, EN ISO 2808, ASTM D 4414." Marrëveshja është e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët dhe është lidhur për aktivitetin e prokurimit "Mbikëqyrja e Projekteve", me nr. të prokurimit 632-264696-2-1-1.

Në pjesën "Dëshmia e kërkuar", AK nuk ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë certifikatë konformiteti, raport testimi, deklaratë të prodhuesit apo ndonjë dokument tjetër të posaçëm që dëshmon se pajisja punon sipas standardeve ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414. Dëshmia e kërkuar nga AK ka qenë dokumentacioni që vërteton pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes, ndërsa OE ka dorëzuar marrëveshjen e kërkuar.

Për rrjedhojë, AK nuk mund ta eliminojë ofertën për mungesën e një dokumenti që nuk është përcaktuar shprehimisht si dëshmi e obligueshme në Dosjen e Tenderit. Një interpretim i tillë përbën vendosje të një kërkese shtesë gjatë fazës së vlerësimit.

Edhe nëse AK ka pasur paqartësi nëse pajisja e ofruar punon sipas standardeve ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414, kjo paqartësi ka mundur të sqarohej përmes kërkesës për informata ose dokumentacion sqarues, pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës. Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me pajisjen nr. 7, AK ka vepruar në kundërshtim me:

- nenin 59 të LPP-së, sepse nuk e ka vlerësuar në tërësi listën e pajisjeve dhe marrëveshjen e dorëzuar;

- nenin 69 të LPP-së, sepse ka kërkuar një dëshmi që nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit;

- nenin 72 të LPP-së, sepse nuk ka kërkuar sqarim për paqartësinë eventuale lidhur me përputhshmërinë e pajisjes me standardet;

- nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, sepse ka mundur të kërkojë dokumentacion sqarues pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës;

nenin 7 të LPP-së, sepse gjatë vlerësimit ka aplikuar një kërkesë më kufizuese se ajo e publikuar në Dosjen e Tenderit.

Kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me pajisjen nr. 7

Pretendimi nr12-OE i rekomanduar për kontratë “AL Engineering” sh.p.k. ka dështuar të dorëzojë Listën e stafit për aktivitetin konkret të prokurimit nr. 632-26-4696-2-1-1.

Dokumenti “Lista e stafit” i dorëzuar nga OE mban numrin tjetër të prokurimit 632-26-4696-22-1. Ndërsa Dosja e Tenderit identifikon aktivitetin “Mbikëqyrja e Projekteve” me nr. 632-26 4696-2-1-1.

Sipas nenit 15 të Rregullores për Prokurimin Publik, numri i prokurimit është unik dhe referencë për aktivitetin e prokurimit.

Prandaj, dokumenti me numër tjetër nuk mund të konsiderohet automatikisht si Lista e stafit për këtë aktivitet. Duke e pranuar këtë dokument dhe duke e shpallur OE fitues, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 69 të LPP-së dhe nenin 40 të Rregullores, pasi OE nuk ka dëshmuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit përmbushjen e kriterit të stafit profesional.

Andaj, konsiderojmë se ky pretendim ankimor është plotësisht i bazuar, pasi OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar Listën e stafit për aktivitetin konkret të prokurimit, ndërsa AK në mënyrë të gabuar e ka konsideruar të përmbushur këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit.

Pretendimi nr13– Shkelje e nenit 59.4 të LPP-së

AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së, duke e konsideruar të përgjegjshëm dhe duke rekomanduar për kontratë OE AL Engineering SH.P.K., ndonëse ky OE nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në FDT.

Konkretisht, për Projekt Menaxherin Sami Lokaj, FDT ka kërkuar që dokumentacioni të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontratë pune apo kontratë mbi vepër, ndërsa për Projekt Menaxherin edhe me vendim për emërim.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se nuk është prezantuar kontratë pune apo kontratë mbi vepër për Sami Lokajn. Madje, vetë OE në dokumentacionin e tij deklaron se Sami Lokaj është pronar dhe drejtor dhe se për të nuk është prezantuar kontrata e punës.

FDT nuk ka paraparë përjashtim nga kjo kërkesë për pronarin apo drejtorin e OE-së. Prandaj, në mungesë të dokumentit të kërkuar, OE nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe nuk ka mundur të konsiderohet tenderues i përgjegjshëm sipas nenit 59.4 të LPP-së. Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

Pretendimi nr14-OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur për z. Nuhi Nuhiu kontratë pune të datës

17.03.2026, në të cilën është shënuar saktësisht tenderi “Mbikëqyrja e Projekteve”, nr. 63226-4696-2-1-1, Komuna e Gjakovës.

Mirëpo, Njoftimi për Kontratë për këtë aktivitet është përgatitur nga AK vetëm më

19.06.2026, pra 94 ditë më vonë. Kjo ngrit çështjen se si ka mundur OE, më 17.03.2026, të dijë paraprakisht titullin dhe numrin e saktë të një aktiviteti që ende nuk ishte shpallur nga AK.

Për më tepër, AK ka kërkuar që stafi profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontratë pune, ndërsa dokumenti i paraqitur për Nuhi Nuhiun pretendohet se është lidhur pikërisht për këtë tender para publikimit të tij. Kjo mospërputhje vë në pikëpyetje vlefshmërinë e dokumentit si dëshmi për përmbushjen e kriterit të stafit dhe njëkohësisht ngrit çështje lidhur me trajtimin e barabartë, transparencën dhe komunikimin e informatave, sipas neneve 7 dhe 55 të LPP Andaj, për shkak të kësaj mospërputhjeje kronologjike dhe faktit se dokumenti i paraqitur nuk përbën dëshmi të rregullt për përmbushjen e kriterit të stafit, AK është dashur ta konsiderojë tenderin të papërgjegjshëm dhe ta eliminojë OE-në e rekomanduar nga procedura, në pajtim me nenet 59 dhe 69 të LPP-së.

Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

Pretendimi nr15-Për pozitën e Inxhinierit të Elektroteknikës, AK ka kërkuar minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme, e cila duhet të dëshmohet me CV.

Në CV-në e z. Zenel Dinaj, periudha 1999–2002 është paraqitur si "Organ mbikëqyrës", ndërsa për periudhat 2002–2005 dhe 2005–2007 figuron si udhëheqës sektori dhe menaxher projekti, jo si mbikëqyrës.

Edhe në pjesën e detajuar të CV-së, mbikëqyrja paraqitet për vitin 2000 dhe periudhën 2001–2003, ndërsa nga viti 2003 e tutje paraqitet si menaxher projekti. Këto periudha të mbikëqyrjes mbivendosen dhe nuk dëshmojnë minimum 5 vite të plota përvojë në mbikëqyrje të projekteve të ngjashme.

Prandaj, CV-ja e dorëzuar nuk e dëshmon kërkesën e AK-së për minimum 5 vite përvojë në projekte të ngjashme. Udhëzuesi Nr. 001/2023 përcakton shprehimisht se kur "CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat", tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

Pretendimi nr16-Për pozitën e Inxhinierit të Elektroteknikës, AK ka kërkuar minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme, e dëshmuar përmes CV-së.

Në CV-në e z. Avdi Morina, megjithëse paraqitet përvojë e përgjithshme profesionale nga viti 1987, nuk dëshmohet minimumi prej 5 viteve përvojë në mbikëqyrje të projekteve të ngjashme. Projektet konkrete të paraqitura në CV e identifikojnë atë kryesisht si projekt menaxher, ndërsa nuk përcaktojnë angazhim dhe periudha konkrete në mbikëqyrje të projekteve.

Andaj, CV-ja e dorëzuar nuk e përmbush kërkesën e AK-së për minimum 5 vite përvojë në projekte të ngjashme dhe AK është dashur ta konsiderojë kriterin të paplotësuar dhe ta refuzojë tenderin e OE-së së rekomanduar.

Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

Pretendimi nr17-Nuk është dëshmuar se termometri për asfalt punon sipas standardit EN 13108

Në Aneksin e pajisjeve është kërkuar instrument/termometër për matjen e temperaturës së asfaltit gjatë procesit të shtruarjes, i cili punon sipas standardit EN 13108. Në ofertë është deklaruar se kjo pajisje sigurohet nga N.Sh. "Test & Ing".

Mirëpo, dokumentacioni i dorëzuar si dëshmi përmban vetëm faturë për:

- matës temperature me sondë digjitale;
- termometër infra të kuq;
- termometër max/min PVC.

Në faturë nuk figuron standardi EN 13108, as ndonjë deklaratë teknike e prodhuesit që e lidh ndonjërin prej këtyre instrumenteve me kërkesën e DT-së.

Në dokumentin doganor paraqiten gjithashtu "termometra të qelqit për matjen e temperaturës (30 deri +50°C)", por përsëri nuk evidentohet standardi EN 13108.

Për më tepër, Aneksi përcakton se duhet t'i bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose dokument tjetër që evidenton performimin e tillë.

Pra, është dëshmuar posedimi i disa termometrave, por nuk është dëshmuar karakteristika obligative që termometri i ofertuar punon sipas EN 13108.

Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

Pretendimi nr18-Mospërputhje substanciale ndërmjet çekanit digjital të deklaruar C386N dhe pajisjes së dëshmuar me faturë C386M

Në Aneks është deklaruar pajisja:

MATEST – Model C386N, për testimin e rezistencës së betonit sipas EN 12504-2.

Edhe manuali teknik i bashkëngjitur është specifikisht për Digital Concrete Rebound Hammer C386N. Manuali përcakton modelin C386N dhe konfirmon se ky model kryen testime sipas UNI EN 12504-2.

Mirëpo, në faturën e blerjes në faqen 14 të dokumentacionit të Test & Ing, pajisja e blerë figuron me kod/model C386M, jo C386N.

Kemi pra tri hallka që duhet të përputhen:

Deklarimi në Aneks → C386N

Manuali teknik → C386N

Fatura e pronësisë → C386M

Kjo nuk është një mospërputhje formale e parëndësishme, sepse dokumenti me të cilin pretendohet pronësia i referohet një modeli tjetër nga modeli për të cilin është paraqitur manuali teknik.

Për rrjedhojë, nuk është dëshmuar në mënyrë të qartë se N.Sh. "Test & Ing" posedon pikërisht pajisjen C386N të deklaruar nga OE dhe për të cilën është dorëzuar dokumentacioni teknik sipas EN 12504-2.

Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

Pretendimi nr19-Nuk është dëshmuar se Koni i Abramsit i ofruar përmbush standardin EN 12350-2

DT ka kërkuar kon metalik me pajisjet përcjellëse për testimin e betonit të njomë përmes metodës së konit të Abramsit, i cili punon sipas standardit EN 12350-2. OE e ka deklaruar këtë pajisje nga N.Sh. “Test & Ing”.

Në dokumentacionin e dorëzuar gjendet vetëm një listë e pajisjeve laboratorike ku figuron:

“Konusi për matjen e konsistencës me pajisjet përcjellëse”, një set.

Gjithashtu ekziston një faturë nga Test Center ku figuron artikulli “SLUMP TEST SETI”, por as në këtë faturë nuk paraqitet standardi EN 12350-2, model konkret, certifikatë konformiteti apo dokument teknik që lidh pajisjen me standardin e kërkuar.

Prandaj, dokumentacioni dëshmon se ekziston një slump test set/kon për konsistencë, por nuk dëshmon elementin teknik të kërkuar nga DT: përputhshmërinë me EN 12350-2.

Pretendojmë se deklarimi i standardit në vetë Aneksin e plotësuar nga OE nuk mund të zëvendësojë certifikatën ose dokumentin teknik që duhet ta evidentojë këtë performancë.Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

Pretendimi nr20-TERRATEST 4000 STREAM nuk dëshmon kërkesën për Modulin Dinamik DHE Modulin Statik dhe nuk dëshmon EN 13792

Ky është pretendimi teknik më i fortë.

DT ka kërkuar:

“Pllakë për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave të konstruksionit të rrugës (Moduli Dinamik dhe Moduli Statik) sipas standardit EN 13792.”

OE ka deklaruar TERRATEST 4000 STREAM nga N.Sh. “Test & Ing”.

Dokumenti unik doganor dëshmon se pajisja është TERRATEST 4000 STREAM, nr. serik 8169, e përshkruar si deflektometër për matjen e ngjeshmërisë së tokës.

Por dokumentacioni teknik i prodhuesit e identifikon shprehimisht TERRATEST 4000 STREAM si:

“Light Weight Deflectometer – According to ASTM E2835-11 and German Standard TP BF-StB B8.3.”

Dokumentacioni i vetë prodhuesit bën dallim të prerë ndërmjet testimit statik dhe dinamik:

- Ev2 → static load plate test sipas DIN 18134;
- Evd → dynamic load plate test sipas TP-BF-StB B8.3.

Kjo dëshmon se pajisja e paraqitur është për testimin dinamik, ndërsa testi statik trajtohet si metodë tjetër. Për më tepër, dokumentacioni teknik i dorëzuar nuk identifikon EN 13792, por ASTM E2835-11 dhe TP BF-StB B8.3.

Prandaj, TERRATEST 4000 STREAM nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës kumulative "Moduli Dinamik dhe Moduli Statik", dhe as standardin EN 13792 të përcaktuar në Aneks.

Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

Pretendimi nr21-Dokumentacioni teknik i dorëzuar për ZMM 5000 nuk dëshmon standardet ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414

DT kërkon:

Instrument për matjen e trashësisë së ngjyrës sipas ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414.

OE ka deklaruar Zehntner ZMM 5000, në pronësi të Traffiks VA.

Në faturën e dorëzuar nga Traffiks VA figuron pikërisht "Instrument për matjen e trashësisë së ngjyrës Zehntner, ZMM 5000". Pra, modeli i blerë është i qartë.

Edhe faqet 22–23 të dokumentacionit teknik janë manuali për ZMM 5000.

Mirëpo, faqja ku paraqiten standardet:

ISO 2808, EN ISO 2808, ASTM D 4414

nuk është manual i ZMM 5000. Ajo është shprehimisht "ZND 2050–2054 Instruction manual", dhe standardet e mësipërme paraqiten për serinë ZND 2050–2054.

Pra:

Pajisja e deklaruar/blerë → ZMM 5000

Dokumenti që përmban standardet e kërkuara → ZND 2050–2054 Kjo është një mospërputhje e drejtpërdrejtë dokumentare.

Nuk mund të përdoret dokumentacioni teknik i një modeli tjetër për të dëshmuar se ZMM 5000 përmbush ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414. Për këtë arsye kërkesa e Aneksit nuk është dëshmuar me dokumentet e paraqitura.

Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Grupi i Operatorëve Ekonomikë P.M.N. SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS-MI, me dt. 05.08.2026, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbikëqyrja profesionale", Nr. i prokurimit - 632-26-4696-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-031-211.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, me datë ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se më datë 04.08.2026, në ora 10:31, e keni njoftuar Autoritetin Kontraktues lidhur me pranimin e dokumentacionit të gabuar nuk qëndron. Nga evidenca në sistemin

elektronik të prokurimit rezulton se Autoriteti Kontraktues është njoftuar për këtë gabim më datë 04.08.2026, në ora 15:38.

Të nesërmen, më datë 05.08.2026, jeni njoftuar menjëherë në orën 09:44 nga Autoriteti Kontraktues se, gjatë shkarkimit dhe bartjes së dosjes në USB, kishte ndodhur një gabim teknik dhe se mund të paraqiteshit përsëri për marrjen e dokumentacionit të saktë. Megjithatë, duke pasur parasysh afatin e shkurtër kohor në dispozicion, në orën 10:19 keni kërkuar që dokumentet përkatëse t'ju përcilleshin urgjentisht përmes postës elektronike (e-mail).

Autoriteti Kontraktues, menjëherë pas pranimit të kësaj kërkese, duke filluar nga ora 11:23, ka bërë dërgimin e dokumenteve të kërkuara, ndërsa e-maili i fundit me dokumentet e bashkëngjitura është dërguar në ora 11:39 (siç dëshmohet nga e-mail-at e bashkëngjitur më poshtë). Andaj, nuk qëndron pretendimi juaj se dokumentacioni nuk ju është vënë në dispozicion deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, pasi kërkesa juaj për rishqyrtim është pranuar përmes sistemit elektronik të prokurimit në ora 11:46, gjë që vërtetohet edhe nga evidenca përkatëse në sistemin e e-prokurimit.

Në këtë drejtim, theksohet se afati ligjor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim ka qenë deri në ora 16:00, ndërsa dokumentacioni i kërkuar ju është vënë në dispozicion brenda këtij afati, përpara skadimit të afatit ligjor.

Bazuar në UDHËZUESIN Nr. 001/2023 Prokurim Publik kur: nuk plotëson kërkesën minimale të dosjes së tenderit, ofertën pa kërkuar sqarim shtesë.

Andaj,Pretendimi juaj lidhur me Driton Kabashi, është i pabazuar sepse CV e ofruar nuk e përmbushë kërkesën minimale për përvojën e punës që është kërkuar për arkitektin.

Në FDT-ë është kërkuar që të dëshmohet me CV përvoja e punës e cila ishte minimum 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit, nën sqarimin e DT-së se: Përvoja profesionale nënkupton që i përgjigjet projekteve të ngjashme, 5 vjet pas diplomimit.

Arkitekti i prezantuar ka përfunduar studimet më [data nuk figuron në tekst], ndërsa në CV nuk është prezantuar me saktësi përvoja e punës pas diplomimit.

Në pikën 1 të përvojës së punës në CV thuhet se ka përvojë pune që nga viti 2015 e gjer më tani në kompaninë NN "Kabashi", CV nuk ka datë se kur është krijuar.

Ndërsa është kontrolluar edhe referenca si dëshmi shtesë, edhe pse nuk është kërkuar në DT referenca si dëshmi, me qëllim të qartësimit të CV-së janë kontrolluar edhe referencat ku ka rezultuar se referenca e lëshuar nga NN "Kabashi" është e përpiluar në janar 2019, ndërsa tregohet se z. Kabashi që nga [data nuk figuron në tekst] është pjesë e kompanisë si inxhinier i arkitekturës.

Kjo referencë nuk përputhet me datat e shprehura në CV, dhe si e tillë nuk ka të dëshmuar përvojën 5-vjeçare pas diplomimit.

Pra, edhe pas përpjekjeve për t'i vërtetuar pretendimin tuaj në lidhje me përvojën e punës për z. Kabashi, nuk kemi arritur të vërtetojmë në bazë të CV-së dhe dëshmive shtesë që keni ofruar.

Pretendimi juaj lidhur me Inxhinierin e Elektrikës z. Lulzim Halitaj, është i pabazuar sepse CV e ofruar nuk e përmbushë kërkesën minimale për përvojën e punës që është kërkuar për inxhinierin

e elektrikës.

Në FDT-ë është kërkuar që të dëshmohet me CV përvoja e punës e cila ishte minimum 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit, nën sqarimin e DT-së se: Përvoja profesionale nënkupton përvojë që i përgjigjet projekteve të ngjashme.

Inxhinieri i Elektrikës i prezantuar, ka përfunduar studimet më 04.05.2018, në CV nuk është prezantuar përvoja e punës pas diplomimit në projekte të ngjashme.

Janë kontrolluar edhe referencat si dëshmi shtesë, edhe pse nuk është kërkuar në DT referenca si dëshmi, me qëllim të qartësimit të CV-së janë kontrolluar edhe referencat ku ka rezultuar:

Referenca nga Euro-Ing nuk përputhet me CV, detyrat në referencë janë tjera, në CV tjera.

Referenca e Syla Group Sh.p.k. tregon që ka punuar në projektim e jo mbikëqyrje të projekteve.

Pra, edhe pas përpjekjeve për të vërtetuar pretendimin tuaj në lidhje me përvojën e punës për z. Halitaj, nuk kemi arritur të vërtetojmë në bazë të CV-së dhe dëshmive shtesë që keni ofruar.

Pretendimi juaj lidhur me Inxhinierin e Gjeodezisë z. Luan Abazi, është i pabazuar sepse CV e ofruar nuk e përmbushë kërkesën minimale për përvojën e punës që është kërkuar për inxhinierin e gjeodezisë.

Në FDT-ë është kërkuar që të dëshmohet me CV përvoja e punës e cila ishte minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, nën sqarimin e DT-së se: Përvoja profesionale nënkupton përvojë që i përgjigjet projekteve të ngjashme.

Studimet në nivelin Master në Gjeodezi z. Abazi i ka përfunduar më 18.02.2014, në CV nuk është prezantuar përvoja e punës pas diplomimit.

Janë kontrolluar edhe referencat si dëshmi shtesë, edhe pse nuk është kërkuar në DT referenca si dëshmi, me qëllim të qartësimit të CV-së janë kontrolluar edhe referencat ku ka rezultuar që nuk ka përvojë 5-vjeçare pas diplomimit, siç është kërkuar në DT.

Pretendimi juaj lidhur me bachelorin e Inxhinierisë së Gjeodezisë Agron Shabani, është i pabazuar sepse CV e ofruar nuk e përmbushë kërkesën minimale për përvojën e punës që është kërkuar për inxhinierin e gjeodezisë.

Në FDT-ë është kërkuar që të dëshmohet me CV përvoja e punës e cila ishte minimum 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit, nën sqarimin e DT-së se: Përvoja profesionale nënkupton përvojë që i përgjigjet projekteve të ngjashme.

Shabani, bachelor i Gjeodezisë, ka përfunduar studimet më 27.07.2011, në CV nuk është prezantuar përvoja e punës pas diplomimit që i përgjigjet projekteve të ngjashme.

Janë kontrolluar edhe referencat si dëshmi shtesë, edhe pse nuk është kërkuar në DT referenca si dëshmi, me qëllim të qartësimit të CV-së janë kontrolluar edhe referencat ku ka rezultuar që nuk ka përvojë 5-vjeçare pas diplomimit, siç është kërkuar në DT.

Pretendimi juaj lidhur me pajisjen nr. 1 është i pabazuar, sepse mungon dëshmia që pajisja me nr. 1 në listën e pajisjeve është në gjendje të rregullt teknike dhe është e kalibruar;

Pretendimi juaj lidhur me pajisjen nr. 2 është i pabazuar, sepse mungon dëshmia që pajisja me nr. 2 në listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 13108;

Pretendimi juaj lidhur me pajisjen nr. 4 është i pabazuar, sepse mungon dëshmia që pajisja me nr. 4 në listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 12350-2;

Pretendimi juaj lidhur me pajisjen nr. 5 është i pabazuar, sepse mungon dëshmia që pajisja me nr. 5 në listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 13792;

Pretendimi juaj lidhur me pajisjen nr. 7 është i pabazuar, sepse mungon dëshmia që pajisja me nr. 7 në listën e pajisjeve punon sipas standardit ISO 2808, EN ISO 2808, ASTM D 4414.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 03.09.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0613 ndërsa me datë 16.09.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0613, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e "P.M.N." SH.P.K & NPN "UNIVERS-MI "eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0613 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Tenderuesi Ankues, "P.M.N." SH.P.K & NPN "UNIVERS-MI" Prishtinë, ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 05.08.2026, përderisa AK me datë 10.08.2026 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Tenderuesi Ankues, deklaron se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK-KOMUNA E GJAKOVËS të datë 31.07.2026 dhe PRETENDON se AK ka bërë gabim gjate vlerësimit të tenderit.

Tenderuesi ankues GOE “P.M.N.” SH.P.K & NPN “UNIVERS-MI” Prishtinë pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 10 të LPP-së, duke mos i mundësuar qasje të plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Sipas GOE-së, gjatë qasjes së datës 03.08.2026 i është dorëzuar gabimisht dokumentacioni i N.N.P. “VETONI”, operator jopjesëmarrës në këtë aktivitet dhe që i përkiste një projekti tjetër. Pas njoftimit për gabimin, dokumentacioni i saktë është kërkuar urgjentisht përmes e-mailit, me arsyetimin se afati për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim skadonte më 05.08.2026.

Në këtë bazë, GOE pretendon se veprimet e AK-së kanë cenuar të drejtën e saj për qasje në dokumentacion dhe kanë qenë në kundërshtim me Nenin 10 të LPP-së dhe Nenin 7.6.2 dhe 7.6.3 të Rregullores Nr. 001/2022, të ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024.

PËRGJIGJE E EKSPERTIT SHQYRTUES NE PRETENDIMIN NR. 1

Pretendimi nr. 1 – Shkelja e Nenit 10 të LPP-së lidhur me qasjen në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë

Lidhur me pretendimin e tenderuesit ankues GOE-së se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 10 të LPP-së, duke mos i mundësuar qasje reale, të plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e ngritur, përgjigjen e Autoritetit Kontraktues, si dhe dëshmitë e paraqitura në kuadër të kërkesës për rishqyrtim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se pretendimi i GOE-së është pjesërisht i bazuar, por jo në tërësi.

Eksperti shqyrtues konstaton se, gjatë qasjes së datës 03.08.2026, Autoriteti Kontraktues, si pasojë e një gabimi gjatë shkarkimit dhe bartjes së dokumentacionit, i ka vënë në dispozicion në vend të tenderuesit të rekomanduar për kontratë GOE-së i ka dorëzuar dokumente që i përkisnin N.N.P. “VETONI”, operator i cili nuk ka qenë pjesëmarrës në aktivitetin përkatës të prokurimit dhe dokumentacioni i të cilit lidhej me një projekt tjetër. Ky fakt dëshmohet nga dokumentet e administruara në lëndë dhe nga procesverbali i hapjes së ofertave.

Në këtë aspekt, eksperti vlerëson se qëndron pretendimi i tenderuesit ankues se dokumentacioni fillimisht i vënë në dispozicion nuk ka qenë dokumentacioni përkatës i operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Për pasojë, GOE-së ankues nuk i është mundësuar që gjatë qasjes së parë të analizojë dokumentacionin që ishte objekt i kërkesës së saj.

Megjithatë, nga shqyrtimi i evidencave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktues, përfshirë fotot/screen-et e sistemit të e-prokurimit dhe komunikimet përmes e-mailit zyrtar, eksperti shqyrtues ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, pasi është njoftuar për gabimin, ka ndërmarrë veprime për korrigjimin e tij.

Konkretisht, sipas evidencave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktues, më 05.08.2026, në ora 09:44, GOE ankues është njoftuar për gabimin e ndodhur gjatë shkarkimit dhe bartjes së dokumentacionit dhe është ftuar për ri qasje në dokumentacionin e saktë. Më pas, pas kërkesës së GOE-së ankues që dokumentacioni të përcillej përmes e-mailit për shkak të afatit të shkurtër në dispozicion, rezulton se Autoriteti Kontraktues ka filluar dërgimin e dokumentacionit përkatës më 05.08.2026, nga ora 11:23, përmes e-mailit zyrtar.

Po ashtu, nga evidenca e sistemit të e-prokurimit rezulton se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur në ora 11:46 të datës 05.08.2026, ndërsa afati për paraqitjen e saj ka qenë deri në ora 16:00 të po kësaj date. Prandaj, dokumentacioni i saktë, sipas dëshmive të administruara në lëndë, i është përcjellë GOE-së ankues para përfundimit të afatit ligjor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues nuk gjen bazë të mjaftueshme për të konstatuar se Autoriteti Kontraktues në tërësi e ka pamundësuar qasjen në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë apo se dokumentacioni përkatës nuk është vënë fare në dispozicion para skadimit të afatit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Megjithatë, fakti që në qasjen e parë janë dorëzuar dokumente të një operatori ekonomik tjetër dhe që korrigjimi i këtij gabimi është bërë vetëm më datë 05.08.2026, pra në ditën e fundit të afatit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim, sipas vlerësimit të ekspertit, ka ndikuar në ushtrimin e plotë dhe komod të së drejtës së GOE-së për shqyrtimin e dokumentacionit. Kjo ka krijuar një situatë të pavolitshme për GOE-në ankues, e cila ka pasur një periudhë shumë të kufizuar kohore në dispozicion për shqyrtimin dhe analizimin e dokumenteve dhe për formulimin e pretendimeve eventuale.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron në tërësi pretendimi për pamundësim të qasjes, pasi dokumentacioni i saktë i tenderuesit të rekomanduar për kontratë rezulton se i është përcjellë GOE-së ankues para skadimit të afatit ligjor dhe kjo dëshmohet nga komunikimet elektronike të paraqitura në lëndë.

Në anën tjetër, qëndron pjesërisht pretendimi lidhur me vonesën dhe gabimin në ofrimin fillestar të dokumentacionit, pasi në qasjen e parë Autoriteti Kontraktues ka vënë në dispozicion dokumentacion të një operatori jo pjesëmarrës dhe të një aktiviteti tjetër të prokurimit. Ky veprim nuk ka qenë në përputhje me qëllimin e sigurimit të një qasjeje të saktë dhe efektive në dokumentacionin përkatës.

Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, eksperti shqyrtues e vlerëson pretendimin nr. 1 si PJESËRISHT TË BAZUAR: i bazuar sa i përket faktit se qasja fillestare është realizuar me dokumentacion të gabuar dhe se korrigjimi është bërë me vonesë, por i pabazuar në pjesën ku pretendohet se GOE-së ankues nuk i është vënë fare në dispozicion dokumentacioni i operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë para skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Prandaj, nga evidencat e shqyrtuara nuk rezulton se ky veprim i Autoritetit Kontraktues ka sjellë në mënyrë të pakthyeshme pamundësimin e GOE-së ankues për ushtrimin e së drejtës së saj për kërkesë për rishqyrtim, megjithëse mënyra dhe koha e ofrimit të dokumentacionit kanë qenë objektivisht të papërshtatshme dhe kanë kufizuar kohën në dispozicion për analizimin e tij.

Pretendimi nr. 2 – shkelje e Nenit 1 dhe Nenit 7 të LPP-së

Ankuesi pretendon se eliminimi i ofertës së tij dhe rekomandimi për kontratë i ofertës me vlerë më të lartë cenon ekonomicitetin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, në kundërshtim me Nenin 1 të LPP-së.

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderit, oferta e GOE-së P.M.N. SH.P.K. & UNIVERS-MI ka qenë 75,762.71 €, ndërsa oferta e GOE-së së rekomanduar për kontratë 97,881.36 €, me një

diferencë prej 22,118.65 €.

Ankuesi pretendon se, nëse oferta e tij është eliminuar pa bazë ligjore, rekomandimi i ofertës më të shtrenjtë paraqet dëm potencial për buxhetin publik dhe cenim të parimit të ekonomicitetit dhe efikasitetit.

Rrjedhimisht, ankuesi kërkon rishqyrtimin e ligjshmërisë së eliminimit të ofertës së tij dhe të rekomandimit për kontratë.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues – Pretendimi nr. 2 Shkelja e Nenit 1 dhe Nenit 7 të LPP-së

Lidhur me pretendimin e ankuesit për shkelje të Nenit 1 dhe Nenit 7 të LPP-së, eksperti shqyrtues ka analizuar vlerat e ofertave dhe mënyrën e vlerësimit të ofertës së ankuesit nga Autoriteti Kontraktues.

Nga Procesverbali i Hapjes së Tenderit rezulton se oferta e GOE-së P.M.N. SH.P.K. & UNIVERS-MI, me TVSH, është në vlerë prej 89,400.00 €, ndërsa oferta e GOE-së të rekomanduar për kontratë AL Engineering SH.P.K., MUH Engineering L.L.C. & HII NR.14 – Prishtinë, me TVSH, është në vlerë prej 115,500.00 €.

Diferenca ndërmjet ofertave është 26,100.00 €, ndërsa oferta e rekomanduar për kontratë është rreth 22.6% më e lartë se oferta e ankuesit, përllogaritur në raport me vlerën e ofertës së rekomanduar për kontratë.

Duke marrë parasysh se, sipas vlerësimit të ekspertit shqyrtues në pretendimet përkatëse, oferta e ankuesit është eliminuar pa bazë për disa nga arsyet e konstatuara nga AK, atëherë rekomandimi i një oferte me vlerë dukshëm më të lartë krijon një pasojë të drejtpërdrejtë në aspektin e ekonomicitetit dhe përdorimit efikas të fondeve publike. Neni 1 i LPP-së synon sigurimin e mënyrës më efikase, transparente dhe të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Gjithashtu, vlerësimi dhe eliminimi i ofertës së ankuesit duhet të bëhen në përputhje me kriteret e përcaktuara paraprakisht dhe pa krijuar trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë, në frymën e Nenit 7 të LPP-së, i cili kërkon trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues të operatorëve ekonomikë.

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh konstatimet e ekspertit për pretendimet e tjera dhe faktin se oferta e ankuesit rezulton me vlerë 26,100.00 € më të ulët se oferta e rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues e vlerëson Pretendimin nr. 2 si i bazuar, pasi eliminimi i ofertës së ankuesit, nëse ajo plotësonte kërkesat e DT-së, ka sjellë një situatë që cenon parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit të shpenzimit të fondeve publike, si dhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Pretendimi nr. 3 – Arkitekti Driton Kabashi

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar gabimisht dokumentacionin e arkitektit Driton Kabashi dhe e ka eliminuar ofertën në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Nenin 59 të LPP-së.

Sipas ankuesit, z. Kabashi ka dorëzuar diplomën Master në Arkitekturë me 303 ECTS, Licencën A, CV-në, kontratën mbi vepër dhe dokumentet tjera të kërkuara. Në CV është deklaruar përvojë profesionale nga viti 2015 e deri më tani, ndërsa referencat profesionale nuk kanë qenë të

përcaktuara në DT si dëshmi e detyrueshme. Ankuesi konsideron se përvoja e deklaruar pas diplomimit më 28.06.2018 e tejkalon kërkesën minimale prej 5 viteve dhe se mospërputhjet eventuale në dokumentet shtesë nuk përbëjnë bazë për eliminim.

Në këtë drejtim, ankuesi kërkon që pretendimi të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me z. Driton Kabashi.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues – Pretendimi nr. 3 (Neni 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Ankuesi pretendon se AK ka vlerësuar në mënyrë të gabuar përvojën profesionale të arkitektit Driton Kabashi dhe, për këtë arsye, e ka eliminuar ofertën në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Nenin 59 të LPP-së.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës, eksperti shqyrtues ka konstatuar se z. Driton Kabashi posedon diplomë Master në Arkitekturë me 303 ECTS, të përfunduar më 28.06.2018, si dhe Licencë A nr. A-0192. Po ashtu, është paraqitur kontrata mbi vepër e datës 03.07.2026, e cila përcakton angazhimin e tij për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve", përfshirë projektimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin.

Në CV-në e tij, z. Kabashi ka deklaruar përvojë profesionale "nga viti 2015 e gjer më tani", ndërsa dokumentacioni i dorëzuar përmban edhe referenca që dëshmojnë angazhime në projektim dhe mbikëqyrje të objekteve. Në veçanti, referenca e Real Invest e datës 02.05.2023 dhe ajo e Euro Stil e datës 05.05.2023 konfirmojnë përvojën e tij profesionale në projektim dhe mbikëqyrje. Referenca e NN "Kabashi", e vitit 2019, gjithashtu evidenton angazhimin e tij si inxhinier i arkitekturës dhe pjesëmarrjen në projekte të ndryshme, në funksionet arkitekt dhe menaxher.

Duke marrë parasysh se nga data e diplomimit 28.06.2018 deri në datën e ofertimit 13.07.2026 kanë kaluar mbi 8 vite, ndërsa CV-ja deklaron vazhdimësinë e angazhimit profesional deri në kohën e ofertimit, eksperti shqyrtues vlerëson se dokumentacioni i paraqitur është i mjaftueshëm për të konstatuar përmbushjen e kërkesës për minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Për më tepër, fakti se në një referencë është shënuar një datë tjetër nga ajo e deklaruar në CV nuk mund të merret si bazë e mjaftueshme për eliminim, sidomos kur referencat nuk janë përcaktuar në DT si dëshmi kryesore për përmbushjen e kësaj kërkese.

Rrjedhimisht, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi nr. 3 është I BAZUAR, pasi dokumentet e dorëzuara dëshmojnë se z. Driton Kabashi i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit për kualifikimin dhe përvojën profesionale të arkitektit. Për këtë arsye, eliminimi i ofertës mbi këtë bazë nuk konsiderohet i drejtë., andaj pretendimi i tij është i bazuar.

Pretendimi nr. 4 – Inxhinieri i Elektrikës, z. Lulzim Halitaj

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar pa të drejtë ofertën e tij lidhur me z. Lulzim Halitaj, me arsyetimin se nuk është dëshmuar minimumi prej 5 viteve përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme.

Sipas dokumentacionit të dorëzuar, z. Halitaj posedon Master në Inxhinieri Elektrike – Elektroenergjetikë, të përfunduar më 04.05.2018, Licencë A nr. E-0042, CV profesionale, kontratë mbi vepër për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve", si dhe Listën e Projekteve të

Menaxhuara.

Nga CV-ja rezulton se ka qenë i angazhuar në EUROING nga viti 2018 deri më 2026 dhe vazhdon, si dhe në projekte të tjera në fushën e projektimit, monitorimit, menaxhimit dhe mbikëqyrjes. Po ashtu, Lista e Projekteve të Menaxhuara 2018–2025 evidenton projekte konkrete të realizuara pas diplomimit.

Duke pasur parasysh se nga diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë kaluar mbi 8 vite, eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa për përvojë minimale 5-vjeçare është përmbushur. Mospërputhjet e evidentuara në disa referenca nuk e ndryshojnë këtë përfundim, pasi referencat nuk janë përcaktuar në DT si dëshmi e detyrueshme.

Ankuesi vlereson se pretendimi nr. 4 është I BAZUAR, pasi dokumentacioni i dorëzuar dëshmon se z. Lulzim Halitaj i përmbush kërkesat e DT-së për kualifikimin dhe përvojën profesionale, dhe për këtë arsye eliminimi i ofertës mbi këtë bazë nuk ka qenë i drejtë.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues – Pretendimi nr. 4 (Neni 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Lidhur me pretendimin e ankuesit për vlerësimin e z. Lulzim Halitaj, eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën e Dosjes së Tenderit, arsyetimin e Autoritetit Kontraktues dhe dokumentacionin e paraqitur në ofertë.

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar Inxhinier i Diplomuar ose Master në Inxhinieri Elektrike, me Licencë A dhe minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme. Si dëshmi janë kërkuar CV-ja, diploma, kontrata e punës ose kontrata mbi vepër dhe lista e stafit. Po ashtu, nga DT rezulton se referencat profesionale nuk janë përcaktuar si dëshmi e detyrueshme.

Nga dokumentacioni i ofertës rezulton se z. Lulzim Halitaj posedon Master në Inxhinieri Elektrike – drejtimi Elektroenergjetikë, të përfunduar më 04.05.2018, si dhe Licencë A nr. E-0042, të vlefshme deri më 14.11.2029. Është paraqitur edhe kontrata mbi vepër e datës 09.07.2026 për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve", ku janë përcaktuar detyrat e tij në projektim, mbikëqyrje dhe menaxhim.

Në CV-në e dorëzuar është deklaruar përvojë profesionale në EUROING nga viti 2018 deri në vitin 2026 dhe në vazhdim, si dhe angazhime profesionale në Syla Group, Valmet AB, Links 4 dhe U Architects. Përshkrimi i detyrave përfshin projektim të instalimeve elektrike, monitorim të zbatimit të projekteve, kontroll të përputhshmërisë me specifikimet dhe standardet, menaxhim dhe mbikëqyrje të ekipeve dhe projekteve.

Gjithashtu, në dokumentacion është paraqitur Lista e Projekteve të Menaxhuara 2018–2025, e cila evidenton një numër projektesh të realizuara në kuadër të EUROING-ut, Syla Group, UA Architects, Consult-Eng, G-Project dhe Studio Links 4, përfshirë projekte ndërtimore, elektrike, menaxhim, projektim dhe auditim energjetik. Kjo listë e konkretizon më tej përvojën profesionale të deklaruar në CV.

Po ashtu, dokumentacioni përmban referenca profesionale. Referenca e EUROING evidenton angazhimin e z. Halitaj nga viti 2018 e në vazhdim dhe përshkruan detyra në udhëheqje/menaxhim të objekteve, llogaritje elektroteknike dhe dokumentacion teknik; ndërsa referenca e Syla Group dëshmon angazhimin e tij në projekte gjatë periudhës 2018–2022.

Nga data e diplomimit 04.05.2018 deri në datën e hapjes së ofertave 13.07.2026 kanë kaluar 8 vite, 2 muaj dhe 9 ditë. Rrjedhimisht, përvoja e deklaruar pas diplomimit në CV, e mbështetur edhe nga lista e projekteve dhe dokumentet tjera të paraqitura, tejkalon minimumin prej 5 viteve të kërkuar në DT.

Eksperti shqyrtues vlerëson se mospërputhjet e evidentuara nga AK në disa referenca, përfshirë gabimin në emër në referencën e EUROING-ut, nuk e mohojnë vetvetiu përvojën profesionale të deklaruar në CV, sidomos kur referencat nuk kanë qenë dëshmi e detyrueshme sipas DT-së. Përmbajtja e CV-së dhe e Listës së Projekteve të Menaxhuara dëshmon angazhime profesionale në projektim, monitorim, menaxhim dhe mbikëqyrje të projekteve.

Në bazë të tërësisë së dokumentacionit të shqyrtuar, eksperti shqyrtues vlerëson se z. Lulzim Halitaj i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit për kualifikimin profesional dhe minimumin prej 5 viteve përvojë pune pas diplomimit në projekte të ngjashme. Prandaj, Pretendimi nr. 4 vlerësohet si i bazuar.

Pretendimi nr. 5 – Inxhinieri i Gjeodezisë, z. Luan Abazi

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar pa të drejtë ofertën për shkak të vlerësimit të përvojës së z. Luan Abazi, duke konstatuar se ai nuk e dëshmon përvojën e kërkuar në projekte të ngjashme.

Nga dokumentacioni i ofertës rezulton se z. Abazi posedon Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi, të përfunduar më 18.02.2014, Licencë nr. 129 për gjeodet të licencuar, CV profesionale dhe kontratë mbi vepër për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve". Në CV është deklaruar angazhim profesional nga janari 2013 dhe në vazhdim, me përvojë në matje gjeodezike, piketim, mbikëqyrje profesionale, matje me GPS/TCR, si dhe në projekte rrugore dhe infrastrukturore.

Nga dokumentacioni plotësues rezulton gjithashtu përvojë konkrete në incizime gjeodezike, rrugë, ujësjellës, kanalizime, piketime dhe mbikëqyrje profesionale, përfshirë projekte të ngjashme me aktivitetin objekt vlerësimi.

Duke marrë parasysh datën e diplomimit dhe përvojën e deklaruar, eksperti shqyrtues vlerëson se z. Abazi e përmbush kërkesën për përvojën profesionale, ndërsa AK e ka interpretuar në mënyrë tepër kufizuese këtë kërkesë.

Ankuesi, Pretendimin nr. 5 vlerëson si të BAZUAR, pasi dokumentacioni i dorëzuar dëshmon kualifikimin dhe përvojën profesionale të z. Luan Abazi, dhe eliminimi i ofertës për këtë arsye konsiderohet i pabazuar.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues – Pretendimi nr. 5 (Neni 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Lidhur me pretendimin e ankuesit për vlerësimin e z. Luan Abazi, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar kërkesat e Dosjes së Tenderit, arsyetimin e Autoritetit Kontraktues dhe tërë dokumentacionin e dorëzuar për këtë pozitë.

Nga dokumentacioni rezulton se z. Luan Abazi posedon Diplomë Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi, të lëshuar më 18.02.2014, si dhe Licencë për Gjeodet të Licencuar nr. 129,

të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, me vlefshmëri deri më 20.10.2028. Po ashtu, është dorëzuar kontrata mbi vepër për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve", e datës 02.07.2026. Dokumentet përkatëse gjenden në pjesët e dokumentacionit të bashkëngjitur.

Nga CV-ja profesionale rezulton se z. Abazi ka qenë i angazhuar nga janari 2013 dhe vazhdon, në cilësinë e ekspertit të gjeodezisë, drejtorit të kompanisë N.SH. "Geo&Metri" dhe gjeodetit të licencuar. Në përvojën e tij profesionale janë përfshirë matje inxhinierike dhe kadastrale, matje gjeodezike, piketim, mbikëqyrje profesionale, matje me GPS dhe TCR, si dhe punë në projekte rrugore dhe infrastrukturore.

Po ashtu, dokumentacioni përmban një numër të konsiderueshëm referencash profesionale, ku evidentohet përvoja e z. Abazi në projekte të ndryshme gjeodezike dhe infrastrukturore, duke përfshirë incizime gjeodezike, rrugë, kanalizime, ujësjellës, piketime, mbikëqyrje dhe menaxhim projektesh. Në një nga referencat e paraqitura përshkruhet edhe angazhimi i tij si menaxher i projektit për "Incizimet gjeodezike për projektet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit".

Eksperti shqyrtues vlerëson gjithashtu se në dokumentacion paraqitet përvojë e drejtpërdrejtë në projekte të ngjashme me objektin e këtij aktiviteti të prokurimit, përfshirë punë në rrugë, kanalizime, ujësjellës dhe mbikëqyrje profesionale. Në dokumentacion evidentohet edhe përvoja në "Mbikëqyrja e projekteve investive Lot 1 / Pjesa 1", e cila është drejtpërdrejt relevante me natyrën e aktivitetit.

Nga data e përfundimit të studimeve, 18.02.2014, deri në datën e hapjes së ofertave, 13.07.2026, kanë kaluar mbi 12 vite. Për më tepër, CV-ja dokumenton angazhim profesional që nga janari 2013 dhe në vazhdim, ndërsa referencat e dorëzuara e konkretizojnë këtë përvojë me projekte dhe detyra profesionale konkrete.

Për këtë arsye, konstatimi i Autoritetit Kontraktues se z. Luan Abazi nuk e dëshmon përvojën e kërkuar nuk përputhet me përmbajtjen e dokumentacionit të dorëzuar. Edhe nëse merret për bazë sqarimi i përgjithshëm i DT-së për minimumin prej pesë viteve përvojë pas diplomimit, kjo kërkesë rezulton e tejkaluar në mënyrë të dukshme.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi nr. 4 është I BAZUAR, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar – diploma, licenca, CV-ja, kontrata mbi vepër dhe referencat profesionale – rezulton se z. Luan Abazi posedon kualifikimin dhe përvojën profesionale të kërkuar, përfshirë përvojë në projekte të ngjashme dhe në mbikëqyrje profesionale.

Pretendimi nr. 6 – Inxhinieri i Gjeodezisë, z. Agron Shabani

Ankuesi pretendon se AK e ka vlerësuar gabimisht përvojën e z. Agron Shabani, duke konstatuar se ai nuk dëshmon përvojën e kërkuar në projekte të ngjashme.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se z. Shabani ka përfunduar studimet në Gjeodezi më 27.07.2011, ndërsa në CV ka deklaruar angazhim profesional nga viti 2013 e tutje në N.SH. "GEO-MAP", në pozitën Drejtues Teknik, me përvojë në punë dhe projekte gjeodezike, infrastrukturore dhe menaxhim projektesh.

Kjo përvojë mbështetet edhe nga referencat profesionale, përfshirë referencën e N.SH. "GEO-MAP", e cila konfirmon angazhimin nga 01.09.2013 e në vazhdim si "Udhëheqës–Mbikëqyrës i punëve gjeodezike dhe kadastrale", si dhe referencën e Pro&Co Group, e cila dëshmon përvojë

në mbikëqyrjen e punëve në projekte të ujësjellësit, kanalizimit, rrugëve dhe urave.

Rrjedhimisht, nga dokumentacioni rezulton se z. Agron Shabani ka përvojën e kërkuar profesionale në projekte të ngjashme dhe se konstatimi i AK-së për mungesë të kësaj përvoje nuk përputhet me dëshmitë e paraqitura. Prandaj, pretendimi nr. 6 vlerësohet si I BAZUAR.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues – Pretendimi nr. 6 (Neni 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Lidhur me pretendimin e ankuesit për vlerësimin e z. Agron Shabani, eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën e Dosjes së Tenderit, arsyetimin e Autoritetit Kontraktues dhe dokumentacionin e dorëzuar për këtë personel.

Sipas kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit për pozitën ë), është kërkuar Bachelor i Gjeodezisë. Në këtë kërkesë specifike nuk është përcaktuar shprehimisht minimumi prej pesë viteve përvojë pas diplomimit. Megjithatë, edhe nëse merret për bazë sqarimi i përgjithshëm i DT-së lidhur me përvojën në projekte të ngjashme prej pesë vitesh pas diplomimit, dokumentacioni i paraqitur nga ankuesi dëshmon se kjo kërkesë është përmbushur.

Nga dokumentacioni rezulton se z. Agron Shabani ka përfunduar studimet universitare në Gjeodezi në vitin 2011, ndërsa në dokumentacion është paraqitur edhe kontratë mbi vepër e datës 07.07.2026 me "P.M.N." SH.P.K., për angazhimin e tij në projektin "Mbikëqyrja e Projekteve", me nr. të prokurimit 632-26-4696-2-1-1, ku detyrat e tij përfshijnë projektim, mbikëqyrje dhe menaxhim.

Po ashtu, z. Shabani posedon Licencë për Gjeodet të Licencuar nr. 380, e lëshuar më 03.06.2026, me afat vlefshmërie deri më 03.06.2031, çka dëshmon se në kohën e ofertimit ka pasur licencim profesional aktiv.

Sa i përket përvojës profesionale, në CV është deklaruar angazhimi nga viti 2013 e tutje në N.SH. "GEO-MAP", në pozitën Drejtues Teknik. Përvoja e deklaruar përfshin udhëheqje të punëve dhe matjeve gjeodezike, menaxhim projektesh, incizime gjeodezike, si dhe angazhime në projekte infrastrukturore.

Këto të dhëna mbështeten edhe nga referencat e dorëzuara. Në veçanti, referenca e N.SH. "GEO-MAP" konfirmon angazhimin e z. Shabani nga 01.09.2013 e në vazhdim dhe e përshkruan si "Udhëheqës–Mbikëqyrës i punëve gjeodezike dhe kadastrale". Në këtë referencë evidentohen projekte konkrete si hartimi i projekteve ideore dhe kryesore, hartimi dhe revidimi i planeve rregulluese, projekte rrugore dhe kanalizime.

Gjithashtu, referenca e Pro&Co Group konfirmon angazhimin e z. Shabani në projekte të ndryshme infrastrukturore, duke përfshirë riparime të gypave të ujësjellësit, ndërtimin e kanalizimeve, rregullimin e trotuareve, asfaltimin e rrugëve dhe ndërtimin e urave, duke e dëshmuar natyrën e përvojës së tij në punë gjeodezike dhe mbikëqyrje të punëve.

Po ashtu, dokumentacioni përmban referenca të tjera të cilat evidentojnë përvojë të z. Shabani në projekte të ndryshme, përfshirë projekte investive, projekte rrugore, kanalizime, ujësjellës dhe infrastrukturë publike. Këto dokumente shërbejnë si dëshmi plotësuese që konkretizojnë përvojën e paraqitur në CV.

Nga data e përfundimit të studimeve, 27.07.2011, deri në datën e hapjes së ofertave, 13.07.2026, kanë kaluar rreth 14 vite, Ndërsa angazhimi profesional i dokumentuar nga viti 2013 deri në datën e ofertimit përbën mbi 13 vite përvojë profesionale. Referencat e dorëzuara e dëshmojnë këtë përvojë me detyra dhe projekte të natyrës së ngjashme me objektin e aktivitetit të prokurimit.

Në këtë drejtim, eksperti shqyrtues nuk e mbështet konstatimin e AK-së se "në CV nuk është prezantuar përvoja e punës pas diplomimit që i përgjigjet projekteve të ngjashme", pasi nga shqyrtimi i kombinuar i CV-së dhe dokumenteve mbështetëse rezulton përvojë profesionale e vazhdueshme dhe konkrete në gjeodezi, matje, piketim, menaxhim dhe mbikëqyrje të projekteve infrastrukturore.

Po ashtu, duhet të merret parasysh se kërkesa e DT-së lidhet me projekte të ngjashme, dhe jo me projekte identike. Përvoja e evidentuar në dokumentacion, veçanërisht në projekte rrugore, kanalizime, ujësjellës, matje dhe mbikëqyrje, ka natyrë dhe përmbajtje profesionale të lidhur drejtpërdrejt me angazhimin e kërkuar për gjeodetin në kuadër të mbikëqyrjes së projekteve.

Eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi nr. 6 është i bazuar. Nga tërësia e dokumentacionit të dorëzuar – diploma, licenca, CV-ja, kontrata mbi vepër dhe referencat profesionale – rezulton se z. Agron Shabani posedon kualifikimin profesional dhe përvojën e nevojshme në projekte të ngjashme, duke e tejkaluar edhe periudhën pesëvjeçare pas diplomimit, nëse kjo kërkesë konsiderohet e aplikueshme për këtë pozitë.

Pretendimi nr. 7 – Pajisja nr. 1: Instrumenti GPS për matje gjeodezike

Ankuesi pretendon se AK e ka eliminuar pa të drejtë ofertën, duke konstatuar mungesën e dëshmisë për kalibrimin dhe gjendjen teknike të pajisjes.

Nga dokumentacioni rezulton se GOE ka dorëzuar Marrëveshjen për qiranë e pajisjeve ndërmjet "P.M.N." SH.P.K. dhe "GeoMetri" SH.P.K., në të cilën pajisja është identifikuar si "Instrumenti GPS për matje gjeodezike (instrumenti duhet të jetë i kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike)".

Meqenëse në DT nuk është kërkuar shprehimisht certifikatë kalibrimi ose dokument tjetër teknik të veçantë si dëshmi, eksperti shqyrtues vlerëson se dokumenti i dorëzuar përmbush kërkesën e përcaktuar.

Prandaj, Pretendimi nr. 7 vlerësohet si I BAZUAR, ndërsa eliminimi i ofertës për këtë arsye konsiderohet i pabazuar.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues – Pretendimi nr. 7 (Neni 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Lidhur me pretendimin e ankuesit, eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën e Dosjes së Tenderit, arsyetimin e Autoritetit Kontraktues dhe dokumentacionin e dorëzuar për pajisjen nr. 1.

Nga Dosja e Tenderit rezulton se është kërkuar Instrument GPS për matje gjeodezike, i cili duhet të jetë i kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike. Ndërsa, si dëshmi është kërkuar dokumentacioni që dëshmon pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes.

Në këtë rast, ankuesi ka dorëzuar Marrëveshje për qiranë e pajisjeve ndërmjet "P.M.N." SH.P.K. dhe "GeoMetri" SH.P.K., të datës 07.07.2026, për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve", me nr. të prokurimit 632-26-4696-2-1-1. Në listën e pajisjeve të kësaj marrëveshjeje, pajisja nr. 1 është identifikuar qartë si "Instrumenti GPS për matje gjeodezike (instrumenti duhet të jetë i Kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike)".

Rrjedhimisht, dokumenti i dorëzuar dëshmon të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes dhe në përshkrimin e saj përfshihet shprehimisht kërkesa që pajisja të jetë e kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike. Eksperti shqyrtues vlerëson se në DT nuk është përcaktuar si dëshmi e veçantë dhe e detyrueshme certifikata e kalibrimit, raporti teknik apo dokument tjetër i posaçëm.

Prandaj, kërkesa e AK-së që të paraqitet një dëshmi shtesë për kalibrimin dhe gjendjen teknike, nëse një dokument i tillë nuk është kërkuar në pjesën e dëshmive të DT-së, nuk mund të shërbejë si bazë për eliminimin e ofertës.

Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi nr. 7 është i bazuar, pasi pajisja nr. 1 është dëshmuar përmes marrëveshjes së shfrytëzimit, me përshkrimin përkatës sipas kërkesës së DT-së.

Pretendimi nr. 8 – Pajisja nr. 2 Instrumenti për matjen e temperaturës së asfaltit sipas EN 13108

Ankuesi pretendon se AK e ka eliminuar pa të drejtë ofertën, duke konstatuar mungesë të dëshmisë se pajisja nr. 2 punon sipas standardit EN 13108.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se GOE ka paraqitur marrëveshjen për shfrytëzimin e pajisjeve, në të cilën pajisja është identifikuar si instrument për matjen e temperaturës së asfaltit, i cili punon sipas standardit EN 13108.

Meqenëse në DT nuk është kërkuar si dëshmi e veçantë certifikatë konformiteti, certifikatë kalibrimi, raport testimi apo deklaratë e prodhuesit, dokumenti i dorëzuar konsiderohet i mjaftueshëm për dëshmimin e pajisjes.

Rrjedhimisht, Pretendimi nr. 8 vlerësohet si I BAZUAR, ndërsa eliminimi i ofertës për këtë arsye konsiderohet i pabazuar.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues – Pretendimi nr. 8 (Neni 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Lidhur me pretendimin e ankuesit, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar kërkesën e Dosjes së Tenderit, arsyetimin e AK-së dhe dokumentacionin e dorëzuar për pajisjen nr. 2.

Nga dokumentacioni rezulton se GOE ka paraqitur Marrëveshje për qiranë e pajisjeve ndërmjet "P.M.N." SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K., për projektin "Mbikëqyrja e Projekteve", me nr. të prokurimit 632-26-4696-2-1-1. Në listën e pajisjeve të marrëveshjes është përfshirë shprehimisht "Instrument (termometër) për matjen e temperaturës së asfaltit gjatë procesit të shtruarjes, i cili punon sipas standardit EN 13108", me sasi 1.

Rrjedhimisht, dokumenti i dorëzuar e identifikon qartë pajisjen dhe standardin teknik të kërkuar. Nga dokumentacioni i shqyrtuar nuk rezulton se në DT është kërkuar si dëshmi e veçantë certifikatë konformiteti, certifikatë kalibrimi, raport testimi apo deklaratë e prodhuesit për këtë

pajisje.

Prandaj, konstatimi i AK-së se “mungon dëshmia që pajisja nr. 2 punon sipas standardit EN 13108” nuk qëndron përballë dokumentit të dorëzuar, i cili e përcakton shprehimisht këtë karakteristikë të pajisjes.

Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi nr. 8 është i bazuar, pasi pajisja nr. 2 është paraqitur dhe identifikuar në dokumentacionin e dorëzuar në përputhje me kërkesën e DT-së.

Pretendimi nr. 9 – Pajisja nr. 4 Kon metalik për testimin e betonit sipas EN 12350-2

Ankuesi pretendon se AK e ka eliminuar pa të drejtë ofertën, duke konstatuar mungesë të dëshmisë se pajisja nr. 4 për testimin e betonit punon sipas standardit EN 12350-2.

Nga dokumentacioni rezulton se është dorëzuar Marrëveshja për qiranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K., ku pajisja nr. 4 është identifikuar me përshkrimin përkatës dhe standardin EN 12350-2.

Meqenëse në DT nuk është kërkuar si dëshmi e veçantë certifikatë konformiteti, raport testimi apo dokument tjetër teknik, eksperti shqyrtues vlerëson se dokumenti i dorëzuar e dëshmon pajisjen sipas kërkesës.

Rrjedhimisht, Pretendimi nr. 9 vlerësohet si I BAZUAR, ndërsa eliminimi i ofertës për këtë arsye konsiderohet i pabazuar.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues – Pretendimi nr. 9 (Neni 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Lidhur me pretendimin e ankuesit, eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën e DT-së, arsyetimin e AK-së dhe dokumentacionin e dorëzuar për pajisjen nr. 4.

Nga dokumentacioni rezulton se GOE ka dorëzuar Marrëveshjen për qiranë e pajisjeve me RICENS SH.P.K., ku pajisja nr. 4 është përfshirë si “Kon metalik për testimin e betonit në gjendje të njëjtë dhe në përputhje me standardin EN 12350-2”. Dokumenti i referohet projektit “Mbikëqyrja e Projekteve”, nr. prokurimit 632-26-4696-2-1-1.

Eksperti shqyrtues vlerëson se, nëse në pjesën “Dëshmia e kërkuar” të DT-së nuk është përcaktuar certifikatë konformiteti, raport testimi apo dokument tjetër i veçantë për dëshmimin e standardit EN 12350-2, atëherë nuk mund të kërkohet pas hapjes së ofertave një dëshmi shtesë e pa paraparë në DT.

Në këtë rast, vetë marrëveshja e dorëzuar e identifikon pajisjen nr. 4 dhe standardin e kërkuar, prandaj konstatimi i AK-së se “mungon dëshmia” nuk është i mjaftueshëm pa identifikuar dokumentin konkret të kërkuar në DT dhe të munguar në ofertë.

Prandaj, Pretendimi nr. 9 vlerësohet si i bazuar, pasi pajisja nr. 4 është paraqitur në dokumentacionin e dorëzuar me përshkrimin dhe standardin e kërkuar, ndërsa eliminimi i ofertës për mungesë të një dëshmie shtesë nuk mbështetet në kërkesat e përcaktuara në DT.

Pretendimi nr. 10 – Pajisja nr. 5 – Pllakë për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave të konstruksionit të rrugës sipas EN 13792

Ankuesi pretendon se AK e ka eliminuar pa të drejtë ofertën për pajisjen nr. 5, duke konstatuar mungesë të dëshmisë se ajo punon sipas standardit EN 13792.

Nga dokumentacioni rezulton se GOE ka dorëzuar Marrëveshjen për qiranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe G&B-Tampon SH.P.K., në të cilën pajisja nr. 5 është identifikuar si "Pllakë për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave të konstruksionit të rrugës (Moduli Dinamik dhe Moduli Statik) sipas standardit EN 13792", me sasi 1.

Meqenëse në DT si dëshmi është kërkuar dokumentacioni për pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit dhe nuk është përcaktuar shprehimisht certifikatë apo raport teknik i veçantë, eksperti shqyrtues vlerëson se dokumenti i dorëzuar përmbush kërkesën e përcaktuar.

Rrjedhimisht, Pretendimi nr. 10 vlerësohet si I BAZUAR, ndërsa eliminimi i ofertës për këtë arsye konsiderohet i pabazuar.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues – Pretendimi nr. 10 (Neni 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Lidhur me pretendimin e ankuesit, eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën e DT-së, arsyetimin e AK-së dhe dokumentacionin e dorëzuar.

Në DT është kërkuar pllaka për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave të konstruksionit të rrugës, sipas standardit EN 13792, ndërsa si dëshmi është kërkuar dokumentacioni i pronësisë ose e drejta e shfrytëzimit të pajisjes.

Nga dokumentacioni rezulton se GOE ka dorëzuar Marrëveshjen për qiranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe G&B-Tampon SH.P.K., të datës 10.07.2026, për aktivitetin "Mbikëqyrja e Projekteve", me nr. prokurimi 632-26-4696-2-1-1. Në marrëveshje është përfshirë pajisja: "Pllakë për testimin e aftësisë mbajtëse të shtresave të konstruksionit të rrugës (Moduli Dinamik dhe Moduli Statik) sipas standardit EN 13792", me sasi 1.

Për rrjedhojë, dokumenti i dorëzuar e identifikon pajisjen dhe standardin teknik të kërkuar, ndërsa nga dokumentacioni i shqyrtuar nuk rezulton se në DT është kërkuar si dëshmi e veçantë certifikatë konformiteti, raport testimi apo deklaratë e prodhuesit.

Prandaj, konstatimi i AK-së se "mungon dëshmia që pajisja nr. 5 punon sipas standardit EN 13792" nuk përputhet me përmbajtjen e marrëveshjes së dorëzuar, e cila e përshkruan shprehimisht pajisjen sipas kërkesës teknike të përcaktuar në DT.

Rrjedhimisht, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi nr. 10 është i bazuar, pasi pajisja nr. 5 është paraqitur dhe dëshmuar përmes marrëveshjes së shfrytëzimit me përshkrimin dhe standardin e kërkuar.

Pretendimi nr. 11 – Pajisja nr. 7- Instrument për matjen e trashësisë së shtresës së ngjyrës

Ankuesi pretendon se AK e ka eliminuar pa të drejtë ofertën për pajisjen nr. 7, për shkak të mungesës së dëshmisë për përputhshmërinë me standardet ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414.

Nga dokumentacioni rezulton se GOE ka dorëzuar Marrëveshjen për qiranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe I.T.K. SH.P.K., ku pajisja nr. 7 është identifikuar me të njëjtin përshkrim

dhe me standardet e kërkuara. Marrëveshja është e lidhur për aktivitetin "Mbikëqyrja e Projekteve", me nr. prokurimi 632-26-4696-2-1-1.

Meqenëse në DT nuk është kërkuar si dëshmi e veçantë certifikatë konformiteti, raport testimi apo deklaratë e prodhuesit, eksperti shqyrtues vlerëson se dokumentacioni i dorëzuar përmbush kërkesën e përcaktuar.

Rrjedhimisht, Pretendimi nr. 11 vlerësohet si I BAZUAR, ndërsa eliminimi i ofertës për këtë arsye konsiderohet i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën e DT-së, arsyetimin e AK-së dhe dokumentacionin e dorëzuar për pajisjen nr. 7.

Nga dokumentacioni rezulton se GOE ka dorëzuar Marrëveshjen për qiranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe I.T.K. SH.P.K., ku pajisja nr. 7 është identifikuar si "Instrument për matje të trashësisë së ngjyrës sipas standardit ISO 2808, EN ISO 2808, ASTM D 4414". Marrëveshja i referohet aktivitetit "Mbikëqyrja e Projekteve", me nr. të prokurimit 632-26-4696-2-1-1, dhe është e nënshkruar nga palët.

Po ashtu, dokumentacioni i bashkëngjitur përmban dëshmi për pajisjen, përfshirë dokumente doganore dhe fotografi të instrumentit, ku paraqitet pajisja e destinuar për matjen e trashësisë së shtresës së ngjyrës.

Meqenëse në DT nuk është kërkuar si dëshmi e veçantë certifikatë konformiteti, raport testimi apo deklaratë e prodhuesit për standardet e përmendura, eksperti shqyrtues vlerëson se dokumentacioni i dorëzuar e identifikon pajisjen sipas kërkesës.

Prandaj, Pretendimi nr. 11 vlerësohet si i bazuar, ndërsa eliminimi i ofertës për këtë arsye konsiderohet i pabazuar.

KONKLUZION I PËRGJITHSHËM

Pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve ankimore të paraqitura nga tenderuesi Grup i OE "P.M.N." SH.P.K. & NPN "UNIVERS-MI" Prishtinë, si dhe pas analizimit të arsyetimeve të Autoritetit Kontraktues dhe dokumentacionit përkatës, eksperti shqyrtues konstaton se, nga gjithsej 11 pretendime ankimore, Pretendimi nr. 1 vlerësohet si PJESËRISHT I BAZUAR, ndërsa Pretendimet nr. 2 deri nr. 11 vlerësohen si TË PABAZUARA.

Duke marrë parasysh gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe në funksion të garantimit të ligjshmërisë së procedurës së prokurimit, transparencës, trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë dhe vlerësimit të rregullt të ofertave, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e "P.M.N." SH.P.K. & NPN "UNIVERS-MI" Prishtinë të APROVOHET SI E BAZUAR, të ANULOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues, dhe lënda të KTHEHET NË RI-VLERËSIM, në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të bëjë rivlerësimin e ofertave në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit të prokurimit publik.

Prandaj, rekomandimi i ekspertit shqyrtues është: APROVIMI I ANKESËS, ANULIMI I VENDIMIT TË AK-së DHE KTHIMI I LËNDËS NË RI-VLERËSIM.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE, me numër të prokurimit: 632-26-4696-2-1-1,

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ja fal besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues dhe pa nevoj që të njëjtat të përsëriten sërish e mbështet edhe rekomandimin e ekspertit se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënje të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E GJAKOVËS**
- OE - **P.M.N. SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: